



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 32/2023 regjistër (JR)  
Datë 17.07.2023

Nr. 48 i vendimit  
Datë 19.06.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 19.06.2025, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Petrit Hysa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 664, datë 24.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Hysa.

**BAZA LIGJORE:** Neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; neni 179/b pika 5 i Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 63, pika 1 e 66, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet shtesë të depozituara në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), sipas së cilave, ai kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 664, datë 24.05.2023, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit Petrit Hysa (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41 pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), prej të cilave rezultoi si më poshtë:
  - 2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm, sipas së cilit: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
  - 2.2. DSIK-ja, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës, ka përcjellë raportin e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.
  - 2.3. KLP-ja kreu vlerësimin e aftësive profesionale, duke analizuar: formularin e vetëdeklarimit dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë këtë formular; tri (3) dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; pesë (5) dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore pranë prokurorive të rretheve dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Në përfundim të procedurës së kontrollit, KLP-ja i dërgoi Komisionit një raport të hollësishëm.
3. Komisioni zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në të tria kriteret e vlerësimit dhe konkludoi me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra me vendimin objekt shqyrtimi. Arsyetimi i Komisionit përmbledhet në vijim.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Vendimi objekt ankimi, nëpërmjet të cilit Komisioni vendosi shkarkimin e subjektit nga detyra, u bazua në vlerësimin përfundimtar se:
  - a. Subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Ai gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, të cilat të vlerësuara së bashku e vendosin në kushtet e *deklarimit të pamjaftueshëm*, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit detyra, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
  - b. Subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. Ai ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës dhe nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
  - c. Në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues të kërkuar, sipas germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. Problematikat e rezultuara në rivlerësimin e aftësive profesionale nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4, e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”.

## III. Shkaqet e ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit

5. Në datën 10.07.2023, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim kundër vendimit të Komisionit, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe konfirmimin në detyrë. Në datën 10.06.2025, subjekti ka paraqitur në Kolegj parashtrime shtesë. Me ankimin dhe me parashtrimet shtesë në Kolegj, subjekti ka depozituar akte<sup>1</sup>, të cilat kërkon të administrohen në cilësinë e provës. Subjekti i rivlerësimit

---

<sup>1</sup> Me ankimin, subjekti ka depozituar njehsimin me origjinalin të akteve: (i) certifikatë ushtrimi profesioni, lëshuar nga Zyra e Tatimeve të rrethit Mat/Burrel; (ii) certifikatë regjistrimi në organin tatimor”, person fizik, lëshuar nga Dega Tatim Taksa e rrethit Mat; (iii) deklaratë e subjektit për sigurimin në periudhën 01.06.1993 – 31.12.1993. Me parashtrimet shtesë në Kolegj, subjekti depozitoi aktet: (i) shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.02.2025, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, së bashku me dokumentin, datë 10.05.1996, “Njoftohen rezultatet e provimit të kualifikimit të avokateve” ku me nr. rendor 43 dhe me nr. rendor 8, evidentohet emri subjektit dhe shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 15.01.2025, e Arkivit Qendror Shtetëror me akte shoqëruese, rregullore, program provimi avokatie; (ii) dy deklarata noteriale, datë 03.02.2025 dhe 04.02.2025, të individëve F. Gj. dhe G. K.; (iii) kërkesë, datë 16.04.2025, drejtuar Bashkisë Mat dhe kthimi i përgjigjes nr. {\*\*\*} prot., datë 23.04.2025, për pagën e vlerësueshme të subjektit të rivlerësimit për periudhën 01.10.1992-30.08.1995; (iv) raporti i ekspertimit kontabël, datë 09.06.2025, i audituesit ligjor A. M.; (v) raport vlerësimi i banesës, datë 03.06.2019, i ekspertes L. B.; (vi) lista e pagave e shoqërisë “{\*\*\*}” për periudhën janar 2001 - dhjetor 2001 për punësimin e M. H.; (vii) libere pune në emër të M. D.; (viii) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për M. D./H., për periudhën 01.01.1994 – 31.10.1996; (ix) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për M. D./H. për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022; (x) vërtetimet, datë 18.10.2016 dhe 26.03.2018, lëshuar nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit për M. H.; (xi) vërtetim, datë 20.10.2016, i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për punësimin dhe pagën e M. H.; (xii) vërtetimi, datë 11.03.2016, i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Berat dhe vërtetimi me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.03.2023, i Inspektoratit Kombëtar i Mbrojtjes së Konsumatorit, për pagën e M. H.; (xiii) certifikatë regjistrimi si avokat në organin tatimor dhe certifikatë ushtrimi profesioni avokat nr. {\*\*\*}; (xiv) ekstrakt historik i regjistrimit të personit fizik {\*\*\*} me administrator K. D.; (xv) 16 fatura shitjeje lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ISKSh Tiranë për {\*\*\*}; (xvi) libër shitjesh i {\*\*\*} “{\*\*\*}”, për vitin 2006 (xvii) libri i blerjeve i {\*\*\*}, “{\*\*\*}”, për vitin 2006; (xviii) libër shitjesh i {\*\*\*}, “{\*\*\*}”, për periudhën 17 - 30.04.2003; (xix) libër blerjesh i {\*\*\*} ShPK, “{\*\*\*}”, për muajin qershor 2004; (xx) libri i shitjeve i {\*\*\*}, ShPK “{\*\*\*}”, për periudhën korrik 2004 – dhjetor 2004; (xxi) listë lëvizje/ekstrakt llogarie e subjektit tregtar {\*\*\*} ShPK, për periudhën 01.01.2006 – 31.12.2006, printuar më datë

kërkon kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, riçeljen e hetimit gjyqësor për një vlerësim të drejtë të fakteve për kriterin e pasurisë, administrimin e provave të reja, rivlerësimin e fakteve e provave, kryerjen e rivlerësimit financiar lidhur me godinën e banimit 3 + 1 kat nën tokë të ndodhur në Shkozë, Tiranë dhe plotësimin e veprimeve të karakterit provues procedural, sipas kërkesave, shpjegimeve e provave të parashtruara prej tij pas njoftimit të rezultateve të hetimit, në seancë dëgjimore dhe provave të parashtruara në ankim. Në përfundim, bazuar në provat që administrohen dhe ato që mund të administrohen, si dhe në zbatim të parimeve të objektivitetit e proporcionalitetit, subjekti i rivlerësimit kërkon ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 664, datë 24.05.2023 dhe konfirmimin e tij në detyrë.

6. Subjekti i rivlerësimit potencon shkaqe ankimi me natyrë procedurale, që lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe shkaqe që lidhen me themelin e çështjes, e konkretisht kundërshtime lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë. Shkaqet e ankimit përmbledhen në vijim, të grupuara në ato me natyrë procedurale dhe në ato me objekt vlerësimin e pasurisë.

### **III/1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale**

6.1. Subjekti pretendon se Komisioni, gjatë zhvillimit të procedurës dhe shqyrtimit në tërësi të provave, ka vepruar në shkelje të parimeve të ligjshmërisë, të drejtësisë, të mbrojtjes juridike të të drejtave e lirive kushtetuese të individit, të proporcionalitetit dhe të objektivitetit. Këto pretendime janë parashtruar të përmbledhura, si parime në pjesën fundore të ankimit.

### **III/2. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë**

6.2. Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit nuk përputhet me rezultatin përfundimtar të procesit dhe me vlerësimin tërësor të procedurave. Konkluzionet e Komisionit në vendimin përfundimtar janë të gabuara dhe rrjedhojë e vlerësimit jo të drejtë të provave të administruara gjatë këtij procesi, shpjegimeve të dhëna dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore. Konkluzionet lidhur me të ardhurat e tij nga avokatia dhe të ardhurat e huadhënësit, kunatit të tij, K. D., janë nxjerrë pa marrë në konsideratë faktin se subjekti gjendet në kushtet e pamundësisë objektive, në kuptim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

6.3. Vendimi është në shkelje të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016.

6.4. Subjekti nuk gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të pasurive, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklaramit të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. Pasaktësitë e konstatuara në deklaramit e subjektit të rivlerësimit nuk përbëjnë deklaramit kontradiktore dhe nuk dëshmojnë përpjekje të tij për të fshehur apo paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo përdorim. Subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve. Për rrjedhojë, pasaktësitë nuk

---

06.03.2007, nga Raiffeisen Bank; (xxii) një USB në të cilën gjenden aktet e mësipërme dhe pamje filmike të banesës në Shkozë.

duhen konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm dhe nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë.

**6.5.** Konkluzioni i Komisionit, për pasurinë *godinë banimi 3 kate + 1 kat nën tokë ndodhur në Shkozë*, është rrjedhojë e vlerësimeve të gabuara lidhur me: (a) saktësinë dhe vërtetësinë e deklarameve; (b) vlerën/koston e investimit; (c) kontributet financiare në ndërtimin e objektit; dhe (ç) burimet e ligjshme të përdorura për krijimin e kësaj pasurie. Pretendimet konkrete do të shtjellohen në gjerësisht në vijim të këtij vendimi të Kolegjit.

**6.6.** Në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë *gjendje cash në shumën 1.050.000 lekë*, subjekti potencon se pavarësisht pasaktësive që mund të ketë pasur në deklaram, shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ kanë sqaruar linjën logjike të ndjekur prej tij lidhur me deklaramet e gjendjes *cash* në banesë, në të cilat ka konsideruar shtesat e likuiditeteve gjendje në banesë dhe ato në llogari bankare.

**6.7.** Për *apartamentin me sipërfaqe 95,26 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë*, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka bërë deklarame vërteta dhe jokontradiktore. Ai dhe personat e lidhur me të kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti. Rezultati negativ financiar i konkluduar për këtë pasuri është rrjedhojë e vlerësimit të gabuar të Komisionit, lidhur me burimet e përdorura për krijimin e saj dhe i mospërfshirjes së tyre në analizën financiare të kryer për këtë pasuri. Subjekti pretendon se nuk ka bërë deklarame kontradiktore në lidhje me dy hua të marra respektivisht nga kunati i tij dhe nga një mik i subjektit. Subjekti ka provuar marrjen realisht të dy huave, mungesën e konfliktit të interesit me huadhënësit si edhe mundësinë financiare të huadhënësve për dhënien e shumave respektive, subjektit të rivlerësimit.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit**

##### **A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj**

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja me objekt shqyrtimi kundërshtimin e vendimit të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Po ashtu, ankuesi legjitimohet *ratione personae*, duke qenë subjekt rivlerësimi, në kuptim të dispozitave kushtetuese e ligjore që rregullojnë këtë aspekt, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.
8. Trupi gjykues i Kolegjit e shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi, në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin gjyqësor në Kolegj, e konkretisht neni 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016<sup>2</sup> dhe

---

<sup>2</sup> “[1.] Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apëlimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51, dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. [...]”.

neni 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012<sup>3</sup>, në kushtet që nuk u konstatua asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga ligji për kalimin në seancë gjyqësore publike në praninë e subjektit, qoftë për aspektet procedurale apo ato të vlerësimit të rrethanave faktike, përcaktuar nga neni 51 i ligjit nr. 49/2012<sup>4</sup>. Në shqyrtim të kërkesës së subjektit për administrimin e akteve të sjella me ankimin dhe parashtrimet në Kolegj përmbledhur në poshtëshënimin nr.1 të këtij vendimi, trupi gjykues vlerëson si vijon:

**8.1.** Disa akte të hartuara para datës së dhënies së vendimit<sup>5</sup>, qartazi nuk plotësojnë kriteret e parashikuara për rastet përjashtimore që normon ligji për provat e reja që lejohen me ankimin, nën dritën e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Në dritën e kësaj dispozite ligjore, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë pamundësinë pa fajin e tij për t'i paraqitur këto akte në Komision. Po ashtu, subjekti nuk rezultoi që të ketë ngritur pretendime me natyrë shkeljesh procedurale të kryera nga Komisioni me fokus kërkimin dhe refuzimin e administrimit të provave të kërkuara prej subjektit. Nga ana tjetër, marrja e tyre në cilësinë e provës vlerësohet e panevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, edhe nëse abstragohet nga mospërmbushja e kushteve përjashtimore të provave të reja me ankimin, në kushtet që informacioni që ato përmbajnë është pa peshë përcaktuese në funksion të konstatimit të plotë e të saktë të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012. Konkretisht:

- (i) ekstrakti historik i shoqërisë “{\*\*\*}”, vërteton faktin që huadhënësi, z. K. D., ishte administrator i shoqërisë dhe jo pronar e as ortak i vetëm në këtë shoqëri;
- (ii) ekstrakti i printuar i llogarisë nga “Raiffeisen Bank” nuk provon asgjë në drejtim të të ardhurave personale të huadhënësit [z. K. D.], pasi shumat e referuara në këtë ekstrakt, janë derdhje të kryera për llogari të personit juridik ku ai ishte administrator;
- (iii) faturat e ISKSh-së Tiranë për rimbursimet e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përpos që datojnë të gjitha pas datës 07.06.2006 [që prezumohet të jetë data e dhënies së huas], referojnë vlerat e rimbursuara, të cilat, sikurse do të trajtohet në vijim, nuk i përkasin individit huadhënës, por shoqërisë tregtare, e cila kishte disa ortakë<sup>6</sup>;

---

<sup>3</sup> Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i cili në nenin 49 parashikon: “1. Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. [...]”.

<sup>4</sup> Neni 51, i ligjit nr. 49/2012 përcakton: “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi, kundër të cilit është paraqitur ankimi, është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. [...]”.

<sup>5</sup> Në këtë grup përfshihen aktet: (i) ekstrakti historik i shoqërisë {\*\*\*}; (ii) ekstrakti i llogarisë, i printuar nga Raiffeisen Bank, për periudhën 01.01.2006 - 31.12.2006; (iii) faturat e ISKSh-së Tiranë, për rimbursimet e shoqërisë {\*\*\*} ShPK; (iv) librat e shitjes dhe blerjes të viteve 2003, 2004 dhe 2006; (v) raport vlerësim i banesës, në Shkozë, datë 03.06.2019, i ekspertës L. B..

<sup>6</sup> Referuar historikut të regjistrimit, K. D. ka qenë përfaqësuesi ligjor i shoqërisë me ortakë K. D., V. N., H. H., D. K., Z. C. dhe L. Ç..

(iv) librat e shitjes të viteve 2003-2006, njëjtë si për faturat, përmbajnë të dhëna vetëm për të ardhura nga shitjet. Ato nuk konfirmojnë fitime as për shoqërinë, dhe në këtë kontekst as nuk provojnë fitime për huadhënësin K. D.;

(v) raporti i ekspertës L. B., depozituar me parashtrimet në Kolegj, nuk përbën provë të re në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, për shkak se subjekti nuk shpjegon dhe aq më pak provon, se nuk ka mundur pa fajin e tij, ta depozitojë këtë akt në Komision<sup>7</sup>. Ky akt rezulton të jetë në prapësim të përllogaritjes së kryer nga Komisioni me rezultatet e hetimit për koston e ndërtimit<sup>8</sup>. Përpos mospërmbushjes së kriterëve për aktet e reja të sjella në Kolegj, trupi gjykues vëren se akti i ri i ekspertimit përmban të dhëna kontradiktore me shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe me të dhënat që referojnë aktet e përcjella nga institucionet kompetente/ALUIZNI, sikurse edhe paraqet një kalendar të ndryshëm të periudhave të ndërtimit për katin e dytë dhe të tretë, duke e shtrirë atë deri në vitin 2013. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit nuk gjen asnjë shpjegim tjetër në depozitim të këtij raport vlerësimi as në momentin e ankimit, por në fazën e parashtrimeve shtesë në Kolegj [vetëm 9 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes në Kolegj], përpos “përpyekjes” së subjektit në funksion të nevojës për t’i shpërndarë periudhat e ndërtimit në vitet që kanë rezultuar me balanca pozitive apo edhe si një “mjet procedural” për të kërkuar kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

**8.2.** Për disa akte të tjera, të përpiluara para dhe pas datës 24.05.2023 të dhënies së vendimit të Komisionit<sup>9</sup>, të cilat referojnë historik punësimi apo të ardhura punësimi, trupi gjykues, në linjë me sa arsyetuar edhe më sipër, e gjen të pakuptimtë depozitim të tyre në fazën e ankimit, në kushtet që nuk provohet pamundësia e subjektit pa fajin e tij për t’i depozituar ato gjatë procesit të rivlerësimit në Komision.

**8.3.** *Së fundmi*, trupi gjykues vlerëson se disa akte të hartuara pas datës 24.05.2023, të dhënies së vendimit të Komisionit<sup>10</sup>, nuk pasqyrojnë të vërtetën. Përpilimi i tyre në fazën e ankimit apo parashtrimet në Kolegj nuk gjen shpjegim tjetër përveçse nevojës momentale të subjektit për të mbështetur pretendimet e tij apo si një “mjet ligjor” për të kërkuar kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Për më tepër, këto akte rezultuan pa peshë përcaktuese për situatën faktike e,

---

<sup>7</sup> Shih edhe paragrafin 17.3. të vendimi të Kolegjit (JR) nr. 9/2022, që i përket subjektit M. B.. Kolegji ka vlerësuar se, në kuptim të nenit 49, të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk legjitimohet që t’i bashkëlidhë parashtrimeve akte të reja si provë. Afati për të paraqitur prova të reja, shtrihet maksimalisht me paraqitjen e ankimit.

<sup>8</sup> Akti i ekspertimit “{\*\*\*}”, datë 04.05.2023, i inxhinieres së ndërtimit S. M., drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

<sup>9</sup> Në këtë grup përfshihen: (i) kërkesë, datë 16.04.2025, drejtuar Bashkisë Mat dhe kthimi i përgjigjes nr. {\*\*\*} prot., datë 23.04.2025, për pagën e vlerësueshme të subjektit të rivlerësimit për periudhën 01.10.1992-30.08.1995; (ii) vërtetimi me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.03.2023, i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Konsumatorit për pagën e M. H.; (iii) lista e pagave e shoqërisë “{\*\*\*}” për periudhën janar 2001 - dhjetor 2001, për punësimin e M. H.; (iv) librezë pune në emër të M. D.; (v) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për M. D./H., për periudhën 01.01.1994 – 31.10.1996; (vi) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për M. D./H., për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022; (vii) vërtetimet, datë 18.10.2016 dhe 26.03.2018, lëshuar nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit për M. H.; (viii) vërtetim, datë 20.10.2016, i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për punësimin dhe pagën e M. H.; (ix) vërtetimi, datë 11.03.2016, i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Berat për pagën e M. H..

<sup>10</sup> Në këtë grup aktesh përfshihen: (i) raporti i ekspertimit kontabël i audituesit ligjor A. M.; (ii) shkresa nr. {\*\*\*} prot, datë 07.02.2025, e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave; (iii) dy deklarata noteriale, datë 03.02.2025 dhe 04.02.2025, të individëve F. Gj. dhe G. K..

për rrjedhje, trupi gjykues e vlerësoi të panevojshme marrjen e tyre, në kuptim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet që subjekti ka zgjedhur ta përpilojë raportin e ekspertimit kontabël pas dhënies së vendimit, e pikërisht *një ditë* përpara depozitimit të parashtrimeve shtesë në Kolegj, pamundësia e përgatitjes së këtij akti me ankimin përjashtohet. Në vijim, korrespondenca shkresore nëpërmjet të cilës provohet vetëm e drejta e ushtrimit të avokatisë, nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas datës 24.05.2023, të dhënies së vendimit të Komisionit dhe as subjekti nuk argumenton pamundësi për marrjen e tyre gjatë hetimit administrativ në Komision. Për më tepër, edhe duke abstraguuar nga mospërbushja e kërkesave ligjore për provat e reja, trupi gjykues e gjen pa peshë përcaktuese edhe në funksion të konstatimit të plotë e të saktë të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, pasi këto akte nuk pasqyrojnë të dhëna, qoftë edhe indirekte për të ardhurat e pretenduara nga kjo veprimtari dhe detyrimeve tatimore lidhur me to. Të dhënat që përmban ky dokument konfirmojnë certifikimin e tij për të ushtruar avokatinë, fakt i cili nuk është vënë ndonjëherë në dyshim nga Komisioni. *Së fundmi*, deklaratat noteriale<sup>11</sup> datë 03.02.2025 dhe 04.02.2025, që referojnë ngjarje nëpërmjet të cilave subjekti tenton të provojë pamundësinë objektive të tij për të marrë shkresa zyrtare nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, përpos që nuk janë hartuar pas datës së dhënies së vendimit të Komisionit e për pasojë, nuk mund të argumentohen si pamundësi për t'i marrë më parë, janë të pabesueshme, pasi bien ndesh me shkresat e përcjella nga DRT-ja Dibër, të cilat nuk e konfirmojnë këtë fakt. Për rrjedhje, marrja e tyre në cilësinë e provës vlerësohet e panevojshme, në kuptim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 edhe nëse abstragohet nga mospërbushja e kushteve përjashtimore të provave të reja me ankimin.

**8.4.** Në përmbyllje të sa më lart, për sa arsyetuar në lidhje me provat, si edhe pasi vlerësoi që nuk rezulton asnjë prej situatave procedurale të parashikuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, për të pasur nevojën e gjykimit të kësaj çështje në seancë gjyqësore publike, trupi gjykues vijoi gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit, mbi bazën e akteve të përcjella në Kolegj nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

## **B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit**

### **B.1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale**

9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka zbatuar parimet e ligjshmërisë, drejtësisë, mbrojtjes juridike të të drejtave e lirive kushtetuese të individit, proporcionalitetit, objektivitetit, shqyrtimit në tërësi të provave e procedurave dhe ka vepruar në shkelje të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016. Ky grup pretendimesh, potencuar për të parën herë në ankim dhe i pakonkretizuar me situata, veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit, vlerësohet nga trupi gjykues i Kolegjit si një përpjekje e subjektit për ta bërë procesin e rivlerësimit të duket si i zhvilluar në shkelje të së drejtës konventore dhe kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Nga analiza kryesisht e sa rezulton nga aktet, trupi gjykues vëren se subjektit të rivlerësimit nuk rezulton t'i jenë mohuar të drejtat kushtetuese e konventore, e as që procesi i tij i rivlerësimit të jetë kryer në shkelje të këtyre parimeve. Nga kontrolli i vendimit objekt ankimi dhe i akteve në dosje, trupi gjykues vëren se

---

<sup>11</sup> *Shih më sipër, deklaratat noteriale. Sipas deklaruesve, gjatë periudhës dhjetor 2006-janar 2007, arkiva e DRT Dibër është përmblytur për shkak të reshjeve atmosferike.*

Komisioni ka respektuar parimet për proces të rregullt, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të KEDNj-së. Hetimi administrativ është kryer në përputhje me kuadrin ligjor të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ligjet që referon ligji nr. 84/2016. Ky konkluzion detajohet në vijim.

**9.1.** Komisioni rezulton të ketë kryer një proces në përmbushje të parimeve të ligjshmërisë dhe të gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Nga aktet në dosje rezulton se Komisioni ka pranuar kërkesën për heqje dorë të një prej komisionereve<sup>12</sup> të shortuara dhe e ka zëvendësuar atë. Ky zëvendësim i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, i cili ka deklaruar<sup>13</sup> se komisioneri O. K. nuk ka konflikt interesi me të. Nga ana tjetër, përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit, me parimet e nenit 6 të KEDNj-së, është certifikuar nga Komisioni i Venecias, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese dhe është konfirmuar edhe nga shqyrtimi nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimin që i përket *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

**9.2.** Sa i përket parimit të drejtësisë, mbrojtjes juridike të të drejtave e lirive kushtetuese të individit, nuk evidentohet asnjë cenim nga veprimet e Komisionit. Në kushtet që ky cilësim është teorik, trupi gjykues ia nënshtroi kontrollit të tij mënyrën sesi Komisioni ka respektuar të gjitha të drejtat e tjera, të cilat në tërësi krijojnë strukturën e procesit të rregullt. Konkretisht, trupi gjykues i Kolegjit vëren se parimi i kontradiktoritetit dhe vlerësimi i provave të parashtruara nga subjekti është respektuar. Në vlerësimin e secilit prej tri kriterëve, Komisioni është bazuar në provat e administruara nga institucionet dhe ato të depozituara nga subjekti. Komisioni i ka drejtuar subjektit të rivlerësimit dy pyetësorë, si dhe ka kërkuar shpjegime dhe dokumentacion provues mbi konstatime e gjetje të ndryshme. Rezultatet e hetimit administrativ i janë komunikuar subjektit, i cili është njohur me aktet e dosjes dhe ka depozituar shpjegimet dhe provat. Subjekti ka bërë tri kërkesa për shtyrje afatesh<sup>14</sup>, të cilat janë pranuar nga Komisioni edhe pse procesi i rivlerësimit është një proces i kufizuar në kohë. Mospranimi i disa kërkesave procedurale të ngritura prej tij, për dëshmitarë apo për të çelur hetimin për aspekte të caktuara që subjekti ka potencuar<sup>15</sup>, nuk mund të argumentohet si shkelje e parimit të kontradiktoritetit apo ndonjë parimi tjetër me natyrë garancish procedurale. Subjekti është njoftuar për refuzimin e kërkesave të depozituara gjatë hetimit administrativ dhe për arsyet e refuzimit. Ai nuk rezulton t'i ketë ankumuar mospranimet e kërkesave në asnjë fazë të hetimit administrativ. Edhe pretendimi për mospërputhje mes rezultateve të hetimit dhe vendimit është i pabazuar, në kushtet që problematikat që kanë çuar

---

<sup>12</sup> Komisionerja S. Zh., ka kërkuar heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes së subjekti të rivlerësimit. Ajo është zëvendësuar me komisionerin O. K..

<sup>13</sup> Me e-mail-in e datës 23.03.2023.

<sup>14</sup> Në pyetësorin nr. 1, të datës 23.01.2023, me afat deri në datën 02.02.2023, Komisioni ka miratuar shtyrjen e afatit për dorëzimin e provave. Përgjigjet dhe provat e këtij pyetësori, janë dërguar pjesë-pjesë në datat 03.02.2023, 09.02.2023, 14.02.2023 dhe 07.04.2023, pra, për një kohë përrreth 2 muaj përtej afatit fillestar. Më datë 18.04.2023, subjekti i rivlerësimit kërkoi zgjatjen e afatit në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, deri më 20.05.2023, kërkesë e cila u pranua nga Komisioni. Më datë 17.05.2023, për së dyti, për arsye shëndetësore, subjekti kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore, gjithashtu, kërkesë e pranuar nga Komisioni.

<sup>15</sup> Me e-mail-in e datës 17.05.2023, Komisioni ka bërë me dije subjektin se ka refuzuar kërkesën për thirrjen e dëshmitarëve, pasi ka administruar deklaratat e tyre noteriale, që nënkupton që dëgjimi i tyre nuk do të sillte të dhëna të reja për procesin e rivlerësimit. Në të njëjtin email, në përgjigje të kërkesës për riçeljen e hetimit administrativ për çdo barrë prove të kërkuar, Komisioni ka njoftuar subjektin se provat, shpjegimet dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, do të vlerësohen nga trupi gjykues para marrjes së vendimit përfundimtar.

Komisionin drejt vlerësimit për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, janë të njëjtat me ato të evidentuara në Rezultatet Paraprake të Hetimit, njoftuar subjektit të rivlerësimit.

**9.3.** Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon subjekti në ankim, provohet përputhshmëria e vendimit të Komisionit me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016. Vendimi objekt ankimi është përpiluar në formën e kërkuar nga ligji, përmban të gjithë elementët dhe plotëson standardet kushtetuese të arsyetimit. Në vendim gjenden të evidentuara kriteret e vlerësimit dhe problematikat e konstatuara për kriterin e pasurisë dhe atë profesional, aktet e depozituara nga subjekti në cilësinë e provës, dokumentacioni i administruar nga Komisioni dhe burimi i marrjes së tij. Këto akte e burime herë citohen në përmbajtje të vendimit e herë në poshtëshënime. Vendimi paraqitet i qartë, me rrjedhshmëri, i arsyetuar dhe me një strukturë të kuptueshme. Për çdo çështje paraqiten rrethanat e faktit, hetimi i kryer dhe konstatimet paraprake të Komisionit, për të cilat i është kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit, qëndrimi i subjektit dhe vlerësimi i këtij qëndrimi nga Komisioni, rivlerësimi i konstatimeve pas shqyrtimit të prapësimeve, i përmbyllur me konkluzionin përfundimtar. Pritshmëria e subjektit të rivlerësimit ka qenë që vlerësimi i provave dhe arsyetimi i Komisionit të përputhej me atë të subjektit. Optika e ndryshme e vlerësimit dhe e analizës së Komisionit, nuk nënkupton mungesë, pamjaftueshmëri apo defekte arsyetimi, por një analizë dhe arsyetim të ndryshëm, që ka prodhuar një konkluzion të ndryshëm nga ai i pritur prej subjektit.

**9.4.** *Së fundmi*, në lidhje me zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, organet e rivlerësimit shkojnë drejt dhënies së një mase disiplinore, duke u bazuar vetëm në standarde objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë, jo vetëm në proporcion me shkeljet e konstatuara, por edhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 1 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka vepruar në respekt të plotë të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Subjektit i ka kaluar barrë prove vetëm pasi Komisioni ka krijuar bindjen se provat kanë arritur nivelin e provueshmërisë të gjetjeve të konstatuara. Si dëshmi për respektimin e parimeve të objektivitetit, mund të përmendim: (i) vlerësimin për të mos e konsideruar një automjet në përdorim si pasuri të fshehur të subjektit, pavarësisht nga disa dyshime të Komisionit; (ii) pavarësisht problematikave të konstatuara në vlerësimin e aftësive profesionale, duke mbajtur në konsideratë numrin e mangësive të konstatuara në raport me kohëzgjatjen e ushtrimit të profesionit, i ka konsideruar mangësitë të pamjaftueshme për t'i shoqëruar me pasojë negative.

## **B.2. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë**

### **B.2.1 Godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë, ndodhur në Shkozë, Tiranë**

- 10.** Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë, të ndodhur në Njësinë Bashkiake Nr. {\*\*\*}, Shkozë, Tiranë. Sipërfaqja totale e ndërtimit për banim është 447,1 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale e truallit 405 m<sup>2</sup>. Për këtë pasuri të paluajtshme janë lëshuar leja e legalizimit, datë 22.09.2015 dhe certifikatë pronësie. Sipas deklaratës, kati nëntokë dhe ai përdhe, me vlerë 1.786.230 lekë, janë investim i subjektit me të ardhurat nga: (i) puna si avokat, si hetues, nga punësimi pranë {\*\*\*}; dhe (ii) me të ardhurat, pjesërisht nga shitja në vitin 1997 e një shtëpie të privatizuar së bashku me prindërit, për të cilën kontrata noteriale e shitblerjes është hartuar në datën 15.11.2001. Ndërsa kati i dytë dhe i tretë (papafingo) në gjendje karabina e

me vlerë 1.613.280 lekë, janë investim i së motrës dhe bashkëshortit të saj, me të ardhurat e tyre nga puna në emigracion në Greqi prej vitit 1998.

**10.1.** Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka deklaruar saktë, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e investimit dhe nuk ka deklaruar me vërtetësi këtë pasuri, referuar germave “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Ky vlerësim u bazua në konkluzionet se: (i) subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të provuar të ardhurat e ligjshme nga ushtrimi i aktivitetit si avokat në vlerën 5.000.000 lekë, për periudhën 1993 - 1997, një pjesë e të cilave ka shërbyer për ndërtimin e banesës në Shkozë; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e punimeve për gërmimin, hedhjen e themeleve dhe përfundimin e katit të parë, deri në fund të vitit 1999, në vlerën 2.956.821 lekë; (iii) subjekti nuk ka bindur Komisionin se një pjesë e investimit ishte e motrës dhe bashkëshortit të saj dhe që jo e gjithë ndërtesa është investim i tij.

**10.2.** Subjekti i rivlerësimit i kundërshton konkluzionet e mësipërme të Komisionit në tërësi, duke pretenduar se ato përbëjnë vlerësim të gabuar lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklaramëve për periudhat e ndërtimit, vlerën/koston e investimit, kontributet financiare për ndërtimin e këtij objekti dhe rezultatit e analizës financiare. Në mënyrë të përmbledhur, argumentet e subjektit janë se:

**10.2.a.** Ka deklaruar saktë kryerjen e punimeve për gjithë etapat që lidhen me katin e parë deri në fund të vitit 1999.

**10.2.b.** Ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi në deklaratën *vetting*, *kontributin financiar* të së motrës në këtë investim. Pavarësisht se kjo pasuri është e regjistruar në emër të tij, ai është investitor i katit nëntokë e përdhe, ndërsa ndërtimi i dy kateve të sipërme të godinës është investim i familjes pasmartesore të motrës. Dokumentacioni i depozituar provon mundësinë e saj dhe të bashkëshortit për të mbuluar me burime financiare të ligjshme pjesën e tyre. Mosdeklarimi i kontributit të tyre për dy katet e sipërme në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2008 është pasaktësi, e cila është ndrequr më pas, me deklaratën për vitin 2015 dhe me shpjegimet e dhëna, më datë 26.02.2016, në ILDKPKI. Subjekti kërkon që investimi i dy kateve të sipërme të mos përfshihet në analizën e tij financiare, pasi nuk përbën shpenzim për të.

**10.2.c.** *Kostoja e ndërtimit* të kësaj godine ka qenë shumë më e ulët se ajo e llogaritur nga Komisioni. Subjekti ka dhënë dy vlera të ndryshme në ankim e parashtrime. Konkretisht, në ankim, sipas tij, kostoja pretendohet në vlerën 3.399.510 lekë, nga të cilat punimet deri në përfundimin e katit të parë janë në vlerën 1.786.230 lekë kundrejt 4.236.584 lekë llogaritur nga Komisioni. Vlera e punimeve të kryera për ndërtimin e karabinasë së katit të dytë dhe të tretë/papafingo është 1.613.280 lekë, përkundrejt vlerës 1.670.054 lekësh përllogaritur nga Komisioni. Ndërsa, sipas parashtrimeve shtesë në Kolegj, kosto totale e investimit pretendohet në vlerën 4.087.444 lekë, e shpërndarë në vitet 1998 – 2013<sup>16</sup>. Subjekti pretendon se kostoja e ndërtimit duhej bazuar në aktin

---

<sup>16</sup>Sipas shpjegimit në faqet 57-58 të parashtrimeve të depozituara në Kolegj: (i) kosto e katit nëntokë dhe katit të parë është 2.446.373 lekë, e shpërndarë gjatë viteve 1998-2001 (në vitin 1998 = 405.429 lekë; në vitin 1999 = 1.114.991 lekë; në vitin 2000 = 609.321 lekë dhe në vitin 2001 = 316.632 lekë.); (ii) kosto e investimit të kryer në vitin 2006, për punimet shtesë në banesë, pretendohet në vlerën 58.595 lekë, ndërkohë që në pyetësorin standard ka deklaruar

e ekspertimit dhe 27 fatura shitjeje tatimore të depozituara prej tij, duke potencuar aspekte të ndryshme të informalitetit të ndërtimit, përfshirë mungesën e lejes, mungesën e punonjësve të specializuar, mjeteve të specializuara dhe mosgjatjen zbatim të detyrimeve tatimore e të tjera financiare.

**10.2.d.** Subjekti pretendon se dispononte *burime financiare* të ligjshme të mjaftueshme për pjesën e tij të investimit, sikurse edhe ka provuar mundësinë financiare të së motrës e bashkëshortit të saj për ndërtimin e dy kateve të tjera të banesës. Ai kërkon që pjesa e deklaruar e së motrës të mos i ngarkohet ekonomisë së tij në analizën e tij financiare. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit në lidhje me burimet e deklaruara për krijimin e të ardhurave: të ardhurat e subjektit nga avokatia; të ardhurat e prindërve nga pensionet; të ardhurat e të vëllait S. H.; si dhe të ardhurat nga emigracioni të motrës së tij dhe bashkëshortit.

**10.3.** Nga analiza e akteve në fashikull dhe pretendimeve në shkaqet e ankimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë në deklaratën *vetting*, ka mungesë burimesh të ligjshme për investimet e kryera ndër vite për krijimin e kësaj pasurie dhe ka kryer deklarim të rremë duke mos pasqyruar me vërtetësi marrëdhënien e tij me një pjesë të saj, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, geramat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është pasqyrim dhe rrjedhojë e problematikave që rezultuan në lidhje me vërtetësinë e deklarimeve të subjektit sa i përket kohës së ndërtimit, kostos së ndërtimit, marrëdhënies pronësore me një pjesë të kësaj godine, e po ashtu edhe e problematikave të rezultuara nga analiza e burimeve të deklaruara për ndërtimin e kësaj banese. Në vijim të këtij vendimi, shtjellohet në detaj analiza e Kolegjit, duke ndjekur shkaqet e ankimit të potencuara për këtë pasuri.

**10.4.** Nga aktet në fashikull, rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti ka referuar të dhënat e përmbledhura më sipër, por jo kohën e krijimit të pasurisë objekt kontrolli. Ndërkohë, në deklaratën e parë, sipas ligjit nr. 9049/2003, në mars 2004, subjekti ka deklaruar banesën në fjalë si: “*Banesë private 3+1, e papërfunduar plotësisht, me vlerë 3 milionë lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit janë kursimet familjare të punës ndër vite, pjesërisht nga shitja e një apartamenti (3+1) në Burrel, përfituar me ligjin për privatizimin e banesave shtetërore*”. Gjatë kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja, në datën 26.02.2016, subjekti ka deklaruar se ndërtimi *ka filluar* në vitin 1995 prej tij, i ati dhe i vëllai, me *themelet* për një banesë 3-katëshe. Punimet janë *pezulluar* dhe kanë *rifilluar* në vitin 1998 me ndërtimin e katit të parë, që sipas subjektit e ka deklaruar në deklaratën e parë për vitin 2003. Burim krijimi kanë qenë kursimet nga *puna* e tij [avokat, pranë Bashkisë Burrel, pranë Komisionit të Pronave, Privatizimit të Banesave dhe si këshilltar i Kryetarit të Bashkisë], si dhe me të ardhurat nga shitja e një shtëpie të përfituar nga privatizimi, me kontratën, datë 15.11.2001. Subjekti është shprehur, po ashtu, se *në vitin 2009* motra e tij që jeton në Greqi investoi për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë, vetëm si karabina. Subjekti është shprehur se ai zotëron vetëm katin e parë dhe bodrumin, përkatësisht me sipërfaqe 146,2 m<sup>2</sup> të ndërtuar në vitin 1995 dhe 40 m<sup>2</sup>. Pjesa tjetër i përket së motrës. Meqenëse kishte aplikuar për

---

*për këto punime vlerën 900.000 – 1.000.000 lekë; (iii) vlera e investimit për katin e dytë dhe të tretë është 1.582.476 lekë, e shpërndarë në vitet 2008-2013 (në vitet 2008-2010 = 1.345.380 lekë; në vitet 2012-2013 = 237.096 lekë.*

legalizim të karabinasë, subjekti e vetëdeklaroi për legalizim edhe pjesën takuese të së motrës, si shtesë në përputhje me ligjin për legalizimin.

**10.5.** Në deklaratën për vitin 2015 [dorëzuar në datën 18.03.2016], subjekti i rivlerësimit ka përsëritur deklaratimet e dhëna rreth 20 ditë më herët në ILDKPKI. Në këtë deklaratë, subjekti deklaroi se në banesën në ndërtim e sipër nga ana e së motrës është bërë një investim në shumën 1.613.280 lekë për ndërtimin e një kati me papafingo, në fazën e karabinasë<sup>17</sup>. Njësoj si më herët në ILDKPKI, subjekti është shprehur se për efekt legalizimi ndërtimi figuron në emrin e tij por pjesa e tij takuese në këto dy kate shtesë është 0%.

**10.6.** Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka deklaruar se ka përfunduar pjesërisht katin përdhe të banesës në janar 2000. Në linjë me sa ka shpjeguar në ILDKPKI, subjekti ka dhënë të njëjtën kronologji për ndërtimin dhe pezullimin e punimeve, duke u shprehur se në janar të vitit 2000 ka nisur të banojë në një pjesë të ndërtesës. Vlera e ndërtimit, sipas këtij deklarimi, është përcaktuar në 1.786.230 lekë. Subjekti, po ashtu, është shprehur se në vitin 2006 janë kryer punime shtesë: ndërtuar muri rrethues i shtëpisë; rregulluar rruga për në garazh; vendosur porta hyrëse; si dhe garazhi, me kosto përafërsisht 900.000 - 1.000.000 lekë. Subjekti vijon shpjegimin se ajo ndërtesë në vitin 2003, me vlerën e tregut *mund të vlerësohej në shumën 3.000.000 lekë*. Në fund, subjekti është shprehur se në vitet 2008 - 2009, mbi katin përdhe, ka investuar motra e tij me bashkëshortin në një shumë prej 1.613.280 lekësh.

**10.7.** I pyetur në lidhje me mosdeklarimin e ndërtimit të katit të dytë dhe të tretë të kësaj godine, në deklaratat periodike për vitet 2008-2014, si edhe për hapat e ndërmarrë për kalimin e pronësisë së katit të dytë dhe të tretë në emër të motrës dhe bashkëshortit të saj që prej legalizimit të objektit në vitin 2015 e në vijim, subjekti është shprehur<sup>18</sup> se mosdeklarimi i kateve ka qenë pasaktësi e ndrequr me shpjegimet në ILDKPKI dhe në deklaratën për vitin 2015. Për mosdeklarimin për periudhën 2008-2014, ka pretenduar se *nuk ka marrë këshillime nga ILDKPKI-ja, kur është pyetur në vitin 2016. Së fundmi*, subjekti ka pretenduar se familja e së motrës nuk ka marrë dokumentet për pronësinë, meqenëse objekti nuk ka përfunduar ende, dhe ata vijnë jo shpesh në Shqipëri.

**10.8.** Bazuar në konstatimet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë lidhur me *kohën e ndërtimit*, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* apo dhe në deklaratimet periodike vjetore kohën e saktë kur është kryer secila fazë e ndërtimit të pasurisë, si dhe përfundimi i saj. Ai ka dhënë versione kontradiktore për këtë element të kontrollit të pasurisë në procesin e rivlerësimit. Ndërsa pranë ALUIZNI-t subjekti ka deklaruar se gjithë ndërtesa është ngritur gjatë periudhës 1999 – qershor 2008, në ILDKPKI, në shkurt 2016, është shprehur se ndërtimi ka filluar në vitin 1995, ndërsa dy katet shtesë janë ndërtuar nga e motra në vitin 2009. Më pas, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka vendosur si kohë të ndërtimit të dy kateve shtesë, periudhën 2008 – 2009, ndryshe nga sa referon deklarimi i tij pranë ALUIZNI-t. Në ankim e parashtrimet në Kolegj, bodrumi dhe kati përdhe, herë pretendohen të jenë ndërtuar në vitet 1993-2000 apo në vitet 1995-2000 [në ankim] dhe herë në vitet 1998 - 2001 [në parashtrimet shtesë],

<sup>17</sup> Pas togfjalëshit “në fazën e”, duket se ka shkëputje të fjalisë, e cila referuar deklaratimeve të subjektit në tërësi, prezumohet të ketë qenë “në fazën e karabinasë”.

<sup>18</sup> Dërguar me e-mail datë 03.02.2023.

ndërsa dy katet shtesë pretendohen të jenë ndërtuar në vitin 2008 [sipas ankimit], ose e shtrirë në vitet 2008 – 2013 [sipas parashtrimeve shtesë]. Ky moment i fundit kohor u prezantua për herë të parë në Kolegj.

**10.9.** Për efekt të kontrollit të mundësive të përballimit të shpenzimeve me burime të ligjshme financiare, nën dritën e përcaktimeve të nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, pasaktësia dhe mospërputhjet e konstatuara në deklaratimet e subjektit për momentin kohor të kryerjes së investimeve, paraqet rëndësi në kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi afekton vlerësimin e *kostos* së ndërtimit. Për sa më sipër, trupi gjykues e vlerësoi të bazuar qëndrimin e Komisionit për kohën e ndërtimit të secilës fazë përkatëse të shtëpisë. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit për koston e ndërtimit kanë qenë kontradiktore në vijimësi. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit e bazoi analizën në metodologjinë e Komisionit. Konkretisht, ndërsa në parashtrimet në Komision dhe në ankim<sup>19</sup> subjekti pretendon një vlerë më të ulët, në parashtrimet në Kolegj<sup>20</sup> kostoja rezulton më e lartë, por e shtrirë *deri* në vitin 2013 dhe e rishpërndarë në vitet ku subjekti ka rezultuar me balancë pozitive. Ky përshkrim kohor bie ndesh me deklarinimin e tij në Komision dhe pranë ALUIZNI-t, por edhe me deklaratën e motrës e bashkëshortit<sup>21</sup>, të cilët shprehen se kanë investuar gjatë periudhës 2008 – 2011. Mungesë besueshmërie rezulton edhe sa i përket raportit të vlerësimit të depozituar me parashtrimet shtesë në Kolegj.

**10.10.** Pa përsëritur sa është thënë më lart<sup>22</sup>, mbi mospërmbushjen e kërkesave përjashtimore që normon ligji për provat e reja me ankimin, ky akt i ri ekspertimi, i hartuar nga një tjetër eksperte, dhe momenti procedural i depozitimit – vetëm 9 ditë përpara shqyrtimit të ankimit në Kolegj – jo vetëm që qartazi është hartuar si nevojë procedurale dhe jo si pasqyrim i të vërtetës, por përbën edhe një aspekt tjetër, në të cilin dëshmohet mungesa e koherencës së subjektit për periudhën kohore kur janë kryer investimet dhe koston e tyre. Në këto kushte, zgjedhja e Komisionit për ta bazuar analizën e koston në vlerat e referencës sipas Entit Kombëtar të Banesave, është qasje e saktë dhe e bazuar, sikurse edhe në linjë me jurisprudencën e Kolegjit<sup>23</sup>. Faturat e depozituara nga subjekti me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, sikurse ka vlerësuar edhe Komisioni, nuk mund të kenë fuqi provuese për punimet e kryera në vitin 1999, në kushtet që datojnë *pas* këtij pragu kohor, ndërsa një pjesë tjetër datojnë pas muajit qershor 2008, gjithashtu *më pas* në kohë, kundrejt punimeve për katin e dytë e të tretë të godinës – nëse i referohemi vetëdeklarimit të kohës nga subjekti pranë ALUIZNI-t. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit mbi përlllogaritje të gabuar të koston së ndërtimit të banesës objekt analize, është i pabazuar në dokumentacion.

---

<sup>19</sup> *Vlera totale prej 3.399.510 lekësh, shumatore e vlerave 1.786.230 lekë dhe 1.613.280 lekë të përshkruara në pikën 14 të ankimit.*

<sup>20</sup> *Në faqet 57-58 të parashtrimeve, totali i pretenduar është në vlerën 4.087.444 lekë, e shpërndarë në vitet 1999-2013.*

<sup>21</sup> *Deklarata, datë 20.10.2016, bashkëlidhur deklaratës vetting.*

<sup>22</sup> *Në pikën 8 dhe nën-pikat e këtij vendimi të Kolegjit.*

<sup>23</sup> *Në pikat 1.23 e vijues të vendimit, Komisioni ka arsyetuar se referuar jurisprudencës së Kolegjit, ka aplikuar përçindjet që zënë punimet në fazën e karabinasë dhe zbritjen e vlerave që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar, duke dëshmuar në këtë mënyrë të kundërtën e asaj që pretendohet nga subjekti se vlera e përlllogaritur nga Komisioni nuk është reale në kushtet ku punimet janë kryer pa iu nënshtruar taksave e tatimeve dhe pa aplikuar norma fitimi.*

**10.11.** Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit për investimin e kryer nga e motra dhe bashkëshorti i saj për dy katet e sipërme të godinës, nuk janë bindëse dhe nuk pasqyrojnë të vërtetën. Në këto kushte, edhe në vlerësimin e Kolegjit, subjekti gjendet në kushtet e *deklarimit të rremë* për mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, pasi nga dokumentacioni ajo rezulton të jetë e gjitha pronë e subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e germës “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë konstatim, trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, mbajti në konsideratë një sërë aspektesh të cilat i bëjnë të pabesueshme shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, qoftë për arsyet për të cilat gjithë aktet që lidhen me ndërtimin dhe pronësinë janë në emrin e tij apo edhe për shkaqet për kryerjen e investimit. Në vijim, shtjellohet arsyetimi i fakteve që rezultuan nga shqyrtimi i akteve në fashikullin e Komisionit.

**10.12.** *Së pari*, trupi gjykues analizoi shpjegimet e subjektit për mënyrën sesi është kryer në terma praktikë investimi nga e motra e subjektit, sipas shpjegimeve të tij, ndërthurur me mundësinë financiare të saj e bashkëshortit, për t'i krijuar shumat e pretenduara. Me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të datës 01.02.2023, të kumatit të tij [z. Xh. C.], sipas së cilës, ai ka *sjellë cash* në Shqipëri vlerën e investimit [rreth 12.000 euro me kursin e kohës]. Në linjë me arsyetime të mëparshme të Kolegjit, për vlerën e kufizuar provuese të deklarimeve të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, ky pretendim i subjektit mbeti deklarativ në tërësi pasi nuk ka asnjë akt tjetër të mëhershëm apo edhe indicie që të mund të konfirmonte këto veprime dhe kalimin e fondeve subjektit për efekt të këtij investimi. Parë përkundër akteve që dëshmojnë të kundërtën – vetëdeklarimi i subjektit në ALUIZNI dhe fakti që prona vijonte të ishte në emër të tij edhe gjatë procesit të rivlerësimit – pretendimi i mësipërm i subjektit, i materializuar për herë të parë për shkak të kontrollit të ushtruar në ILDKPKI, e plotësuar vetëm në vitin 2023 me deklaratën noteriale të kumatit, bëhet i pabesueshëm.

**10.13.** Komisioni ka konkluduar se motra e subjektit dhe bashkëshorti i saj nuk justifikojnë plotësisht vlerën e investimit të deklaruar, pasi kanë rezultuar me një balancë negative burimesh të ligjshme në shumën (-) 1.871 euro për të përballuar investimin<sup>24</sup>. Sipas Komisionit, balanca negative duhet të jetë më e lartë, pasi të ardhurat mbi të cilat është kryer kjo analizë janë në vlerat *bruto*. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke potencuar që shpenzimet jetike të emigrantëve janë më të ulëta sesa ato të qytetarëve vendas/grekë. Sipas tij, një analizë me shpenzime të reduktuara do të mbulonte balancën negative, edhe pa marrë në konsideratë të ardhurat nga punësimet e dyta/të përgjigjuara, që kanë kryer motra dhe kunati i subjektit. Për të provuar të ardhurat nga emigracioni, subjekti ka depozituar bashkëlidhur deklaratës *vetting*, akte<sup>25</sup> e konkretisht: (i) format vetëdeklarimi, datë 21.10.2016, ku kunati deklaroi periudhat e punësimit dhe emrat e punëdhënësve në Greqi; (ii) vërtetim, që mban datën 21.10.2016, për punësimin e motrës së subjektit si pastruese nga data 30.01.2002 dhe vijim pranë një personi juridik të regjistruar në Greqi; (iii) deklaratë të thjeshtë, datë 20.10.2016, lëshuar nga kunati i subjektit, i cili shprehet se jeton në Greqi që nga viti 1998 me bashkëshorten dhe fëmijët. Në vitet 2008 – 2011,

---

<sup>24</sup> Në paragrafin 1.115 e vijues të vendimit, Komisioni ka përlogaritur të ardhurat nga punësimi i motrës e bashkëshortit për periudhën janar 2003- qershor 2008 në shumën 83.493 euro. Ndërsa shpenzimet e jetesës për familjen referuar të dhënave statistikore të EUROSTAT-it për këtë periudhë përlogaritur në përreth 72 mijë euro.

<sup>25</sup> Në formën fotokopje të panoterizuar.

kanë investuar në Tiranë, në marrëveshje me subjektin, në banesën e tij, një shumë prej 12.000 eurosh për vetëstrehim atje, në rast të humbjes së vendit të punës, si rezultat i krizës ekonomike që përfshiu Greqinë. Deklaruesi, po ashtu, shprehet se investimi ka mbetur në fazën e karabinasë për arsye ekonomike. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka shpjeguar se për këtë investim, familja e motrës së tij ka përdorur të ardhura të ligjshme të siguruara, si dhe të ardhura të tjera të pa siguruara (por jo të kundërligjshme) dhe ka depozituar dokumentet<sup>26</sup>: (i) “shënim likuiditeti taksë të ardhurash personash fizikë në bazë të deklarimit të ndryshuar 2”, për kunatin, për vitet 2003 – 2008, nga punësimi në Greqi; (ii) vërtetim, datë 04.09.2020, nga kryetari i Bashkisë Zografou, i cili vërteton se kunati është banues i përhershëm në bashkinë Zografou, Greqi; dhe (iii) lejen e qëndrimit të kunatit, në Greqi, me datë lëshimi 03.02.2020 e vlefshmëri 02.02.2025.

**10.14.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se aktet e depozituara bashkëlidhur deklaratës *vetting* nuk përmbajnë të dhëna mbi *vlerën* e të ardhurave të realizuara. Për rrjedhojë, ato janë pa efekt provues në drejtim të analizës financiare. Të dhënat që referojnë aktet e depozituara me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, rezultojnë të jenë përlllogaritur saktë nga ana e Komisionit. Pretendimi i subjektit për të ardhura edhe nga punësimet e dyta të paregjistruara është deklarativ në thelb, për sa i përket vlerave të përfituara që do të mund të përlllogariteshin kundrejt mundësisë për të kryer investimin, edhe duke abstraguuar nga diskutimi për ligjshmërinë e tyre. Për më tepër, në kushtet që pamundësia e investimit nga motra e bashkëshorti në këndvështrim të balancës negative është vetëm një ndër aspektet me peshë në këtë analizë dhe fakti që të ardhurat e dokumentuara janë në vlerat *bruto*, nënkupton që balanca negative e konstatuar është versioni më i favorshëm i mundshëm. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit është i drejtë dhe i bazuar.

**10.15.** Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit, përpos akteve zyrtare për krijimin e legalizimin e pronës, janë të pabesueshme edhe referuar sa rezultojnë nga aktet e tjera të sjella nga subjekti. Konkretisht, ndërsa subjekti i rivlerësimit është shprehur se motra investoi në Shqipëri për siguri, nisur nga kriza ekonomike që po kalonte Greqia në vitin 2008, me përgjigjet e pyetësorit standard subjekti ka depozituar një deklaratë të kunatit, lëshuar në datën 13.07.2020, ku i deklaron se në datën 29.07.2008 [që referohet si periudha e investimit në banesën në Shkozë], janë mbështetur financiarisht nga Banka e Greqisë, me një kredi pa interesa për blerje banese, me vlerë 138.000 euro, si pjesë e “Programit të familjeve me shumë fëmijë dhe kujdestarëve të anëtarëve të mbrojtur prej tyre me aftësi të kufizuara”. Sipas përshkrimit në kontratën së kredisë pa interesa kreditore, ky program ofron ndihmë për strehim të familjeve me shumë anëtarë. Këto dokumente, krijojnë prezumimin logjik, që të ardhurat e kësaj familjeje, për shkak të krizës ekonomike, por edhe të gjendjes familjare, jo vetëm nuk kanë qenë të larta sikurse pretendohet, por kanë qenë relativisht të ulëta në kushtet që shteti grek e ka gjetur të nevojshme t’i mbështesë me strehim me fonde publike.

**10.16.** Sa i përket kërkesës për të përlllogaritur shpenzime jetese më të ulëta për familjen e së motrës në Greqi, trupi gjykues çmon të theksojë sa është potencuar më sipër – për përlllogaritjen e kryer mbi vlerat e të ardhurave *bruto*. Po ashtu, edhe që përdorimi i një standardi të ndryshëm nga ai i EUROSTAT-it, në mungesë të akteve që të tregonin përse shpenzimet kanë qenë më të ulëta

---

<sup>26</sup> Me e-mail-in e datës 09.02.2023, ka depozituar akte me vulë apostile, hartuar në gjuhën greke, përkthyer dhe noterizuar pranë noteres R. M..

sesa standardi, ka mbetur në nivel deklarativ. Për rrjedhojë, vlerësimi i kryer nga Komisioni është i drejtë e i bazuar, në kushtet që për llogaritjen e vlerës minimale për të jetuar në Greqi për motrën e bashkëshortin e saj, ka referuar të dhënave zyrtare të statistikave nga EUROSTAT, për kategorinë e rezidentëve në nivelin e varfërisë<sup>27</sup>, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit<sup>28</sup>. Nisur nga ky konstatim, rezultoi se Komisioni llogaritjen e shpenzimeve nuk e ka bazuar në nivelin mesatar të jetesës, por në nivelin e minimumit jetik, i cili nuk mund të jetë i diferencuar për qytetarët grekë e për ata emigrantë, pasi ky nivel përfaqëson shpenzimet minimale të domosdoshme për të jetuar.

**10.17.** Në përmbledhje të sa më sipër, edhe nga kontrolli i ushtruar në Kolegj mbi analizën financiare të Komisionit, rezultoi se motra e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj *nuk* kanë pasur mundësi financiare të investonin për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë. Balanca negative e konstatuar në Komision konfirmohet. Në analizën e kryer nga Kolegji, ata rezultuan me mundësi kursimi në vlerën 11.613 euro, ndërkohë që vlera e investimit është 13.558 euro<sup>29</sup>, që nënkupton që pamjaftueshmëria financiare që rezultoi ishte në vlerën (-) 1.945 euro kundrejt vlerës prej (-) 1871 eurosh të rezultuar në Komision. Nën dritën e garancive procedurale me ankimin, gjithsesi, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon balancën negative të konstatuar nga Komisioni, për pamundësinë e motrës së subjektit e familjes së saj për të investuar në dy katet e ndërtesës, sipas pretendimit të subjektit.

**10.18.** Pamundësia financiare e familjes së motrës për investimin ishte një ndër aspektet e marra në konsideratë në kontrollin e kësaj pasurie. Sikurse referuar më sipër, sikurse Komisioni, edhe trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se pretendimet e subjektit me fokus zbritjen e shpenzimeve për dy katet e sipërme, meqenëse janë investim i familjes së motrës janë të pabesueshme, pasi nuk mbështeten nga aktet. Edhe pse subjekti ka pretenduar se e motra ka investuar gjatë viteve 2008 – 2009, ky fakt nuk është deklaruar asnjëherë deri në shkurt 2016 në ILDKPKI, gjatë kontrollit dhe në deklaratën periodike të hartuar pas tij. Subjekti ka shpjeguar pranë ILDKPKI-së se meqenëse kishte aplikuar për legalizim pranë ALUIZNI-t vlerësoi që edhe vetëdeklarimin për legalizimin e pjesës së motrës ta bënte po në emrin e tij si “shtesë”, në përputhje me ligjin për legalizimin, është i pabazuar. Konkretisht, me miratimin e ligjit nr. 50/2014, subjekti ka riaplikuar për legalizim duke dorëzuar pranë ALUIZNI-t deklaratën, datë 22.09.2014, po në emrin e tij për të gjithë godinën. Nëse investimi i dy kateve të tjera do të ishte kryer realisht nga motra e subjektit me miratimin e tij, sikundër pretendohet, në bazë të këtij ligji, motra dhe bashkëshorti nuk kishin asnjë pengesë ligjore për aplikimin për legalizimin në emër të tyre të investimit të kryer prej tyre, sepse ata konsideroheshin pronarë të ndërtimit pa leje, në kuptim të nenit 3, shkronja “g” të këtij ligji<sup>30</sup>. Po kështu, ky ndërtim rezultonte brenda fushës së zbatimit të ligjit nr. 9482/2006, i ndryshuar, me

<sup>27</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC\\_LI01\\_custom%205289581/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom%205289581/default/table?lang=en)

<sup>28</sup> Vendimi nr. 28 (JR), datë 14.07.2022, pika 37 që i përket subjektit të rivlerësimit L. D.; vendimi nr. 18(JR), datë 25.04.2023, pika 12.11, për subjektin F. S. etj.

<sup>29</sup> Vlera 1.670.054 lekë u konvertua sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2008, 1 euro = 123.1825 lekë.

<sup>30</sup> Ligji nr. 50/2014, datë 15.5.2014, në nenin 3 shkronja “g” përcaktonte se: “[...] Pronar i ndërtimit pa leje” është personi fizik ose juridik, që ka kryer vetë ose ka qenë investitor i ndërtimit pa leje dhe vërteton se e posedon ose e disponon lirisht atë dhe parcelën ndërtimore, pavarësisht nga fakti se pronësia mbi to është e paregjistruar në emër të tij në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP)”.

ligjin nr. 50/2014<sup>31</sup>, meqenëse ndërtimi i dy kateve kishte përfunduar brenda muajit qershor 2008, pra, përpara datës 15.01.2009, të përcaktuar në ligj. Për rrjedhojë, përfshirja e objektit në procesin e legalizimit, edhe për ndërtimin e tyre, lejohej. Nën dritën e ligjit, me fjalë të tjera, motra e subjektit e bashkëshorti i saj nuk kishin asnjë pengesë ligjore për të aplikuar për legalizim. *Së dyti*, ky pretendim i subjektit nuk mbështetet as në dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit, në të cilin nuk u gjet asnjë gjurmë ku subjekti të ketë pretenduar bashkëpronësi në këtë ndërtim. Në të gjitha veprimet kontraktuale dhe administrative të kryera për këtë pasuri, që prej momentit të blerjes së tokës<sup>32</sup>, mbi të cilën u ngrit ndërtesa dhe deri në përfundim të procedurës së legalizimit dhe regjistrimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka vepruar si pronar i vetëm. Nuk ka asnjë gjurmë, ku subjekti i rivlerësimit, gjatë kryerjes së procedurave të legalizimit të ketë kërkuar nga ALUIZNI përfshirjen e motrës së tij në këtë procedurë, por ky institucion t'i ketë refuzuar kërkesën.

**10.19.** Pretendimi se subjekti nuk mund të ndërmerre hapa për rregullimin e bashkëpronësisë për shkak të gjendjes “karabina”, rezulton, gjithashtu, i pambështetur në dokumentacion. Referuar lejes së legalizimit dhe dokumentacionit të saj shoqërues<sup>33</sup>, ky objekt është kualifikuar dhe legalizuar si objekt *i përfunduar* dhe jo karabina. E njëjta gjë rezulton edhe nga certifikata e pronësisë dhe kartela e pasurisë ku regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme është bërë si një objekt i përfunduar dhe jo si objekt karabina. Edhe nëse, hipotetakisht, do të pranohej se objekti ishte regjistruar si karabina, subjekti kishte mundësi ligjore për të rregulluar regjimin e pronësisë mbi këtë objekt. Konkretisht, bazuar në ligjin nr. 7843/1994 “*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*”, ligjin nr. 8402/1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 20/2020 “*Për Kadastrën*”, të cilët parashikojnë qoftë regjistrimin e karabinasë në një regjistër të veçantë, ashtu edhe regjistrimin e kontratave lidhur me të<sup>34</sup>, subjekti i rivlerësimit, nëse do të kishte kontrata me të drejta pronësore mbi karabinanë, do të kishte mundësinë, në bazë të nenit 50 të ligjit nr. 20/2020<sup>35</sup>, t'i regjistronte ato në regjistrin e karabinasë. Shpjegimi i subjektit do të bënte kuptim vetëm nëse prona nuk do të ishte e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pasi në atë rast noteri nuk do të kishte mundësi të kryente verifikimet e

---

<sup>31</sup> Ligji nr. 50/2014, datë 15.5.2014, në nenin 2 “*Fusha e zbatimit*” përcaktonte: “[...] Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 15.1.2009, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturale, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj. [...]”.

<sup>32</sup> Sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.09.2006, blerës i tokës mbi të cilën është ngritur banesa objekt kontrolli, është vetëm subjekti i rivlerësimit.

<sup>33</sup> Genplani i objektit, planimetritë e kateve, akti i kualifikimit.

<sup>34</sup> Ligji nr. 7843/1994, në nenin 41/a shtuar me ligjin nr. 9701/2007, parashikonte se: “Regjistruesi, me kërkesë të investitorit dhe të pronarit, bën regjistrimin e përkohshëm të objektit në fazën e përfundimit të karabinasë, si dhe lëshon certifikatën përkatëse, në përputhje me nenin 12/1 të ligjit nr.8402/1998. Ky regjistrim bëhet me kolonë të ndryshme nga ajo e truallit, në të cilin po kryhet ndërtimi dhe është i vlefshëm deri në përfundimin e objektit, për efekt të kreditimit të investitorit ose regjistrimit të kontratave paraprake.[...]. Gjithashtu edhe ligji 20/2020 aktualisht në fuqi, në nenin 49, pika 3 parashikon: [...] 3.Regjistrimi i karabinasë bëhet në një regjistër të veçantë, që quhet “Regjistri i karabinasë”. Çdo regjistrim fillon duke u referuar në ekstremitetet e lejes së ndërtimit, të lëshuar për këtë qëllim. [...]”.

<sup>35</sup> Ligji 20/2020, në nenin, 50 pika 1, parashikon: “[...] 1. Çdo kontratë sipërmarrjeje, porosie apo premtimi shitjeje e investitorit me pronarin e truallit apo me të tretë, që synon në të ardhmen kalimin e pronësisë së objektit në ndërtim, regjistrohet në regjistrin e lejes së ndërtimit dhe më tej në regjistrin e karabinasë. Ky regjistrim e bën njësinë përkatëse të objektit “të zënë” dhe që nuk mund t'i premtohet dikujt tjetër. [...]”.

nevojshme mbi pronësinë në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme<sup>36</sup>. Ky objekt rezulton i regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, duke filluar nga viti 2015. Si rrjedhojë, mbi të mund të kryheshin lehtësisht veprime juridike të njohura nga ligji, përfshirë dhurimin, shitjen e përpjesëtimin apo edhe cilësimin në regjistrim si karabina të ndonjë prej pjesëve.

**10.20.** Në vijim të arsyetimit të mësipërm, është e dukshme që këtë marrëdhënie investimi të së motrës, subjekti e konsideron si një marrëdhënie pronësie. Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, deklarimi nga subjekti se motra dhe bashkëshorti i saj kanë investuar në banesën objekt analize, i konfirmuar edhe nga këta të fundit me deklarata gjatë procesit të rivlerësimit, nuk i bën ata bashkëpronarë. Si më lart shpjeguar, nuk rezultoi që bashkëshortët C. të kenë fituar bashkëpronësinë mbi dy katet e sipërme të banesës, në një nga mënyrat e përcaktuara nga Kodi Civil apo nga ligji. Në rastin konkret, vlerësohet se palët nuk ndodhen përpara një marrëdhënieje bashkëpronësie. Nëse do të pranohej versioni i fakteve të pretenduara nga subjekti, motra dhe bashkëshorti do të ndodheshin përpara një marrëdhënieje detyrimi, ku këta të fundit kanë të drejtë t'i kërkojnë kthimin e shumës së dhënë. Ky vlerësim mbështetet edhe në qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>37</sup>, sipas së cilit: *“Nga marrëdhënia e detyrimit nuk mund të kalohet në marrëdhënien e pronësisë, pasi këto janë dy institute të ndryshme që kanë një rregullim të veçantë në Kodin Civil”*. Në vijim të këtij arsyetimi, edhe nëse nga analiza financiare e kryer në Kolegj do të përmysej rezultati negativ i Komisionit për pamundësinë financiare të M. dhe Xh. C. për kryerjen e investimit të pretenduar, ky rezultat nuk mund të çojë në konkluzionin se këta individë, duke pasur mundësi financiare për kryerjen e investimit, janë bërë automatikisht pronarë të dy kateve të sipërme të banesës.

**10.21.** Në referim të deklaratës së hartuar nga bashkëshorti i motrës së subjektit, në datën 20.10.2016, ku ai shprehet për të drejta strehimi, mund të konsiderojmë të drejtë interpretimin që Komisioni i bën kësaj marrëdhënieje, si një marrëdhënie me elementë të kontratës së dhurimit me kusht, të parashikuar nga nenet 761, 764 dhe 768 të Kodit Civil, ku njëra palë/motra, i ka kaluar palës tjetër/subjektit, një shumë të hollash pakundërshtëpërblim, për kryerjen e investimit në dy kate me kushtin që ta shfrytëzojnë edhe ata sipas nevojave dhe pala tjetër [subjekti] ka pranuar shumën e dhënë, si dhe të drejtën [kushtin] e palës dhuruese për shfrytëzimin e banesës. Për rrjedhojë, edhe parë në këtë këndvështrim, analiza e burimeve financiare të tyre për pasurinë si persona të tjerë të lidhur gjendet e drejtë. E thënë ndryshe, analiza e kryer nga Komisioni për burimet e ligjshme të motrës e bashkëshortit është qëndrim i drejtë, pavarësisht nga këndvështrimi, si persona të tjerë të lidhur apo për efekt të kontrollit në kushtet që ekzistojnë dyshime të arsyeshme për deklarime të rreme apo fshehje të pasurive nga subjekti në emër të personave të tjerë.

**10.22.** Bazuar në këtë arsyetim, pretendimet e subjektit, për investimin e kryer nga e motra dhe bashkëshorti i saj për dy katet e sipërme të godinës, u vlerësuan jobindëse e që nuk pasqyrojnë të vërtetën. Investimi me vlerë 1.670.054 lekë u konsiderua edhe në Kolegj se është kryer nga subjekti i rivlerësimit e, për rrjedhojë, u pasqyrua si shpenzim i tij në analizën financiare të vitit 2008. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer për këtë pasuri, edhe pas korrigjimeve të kryera në Kolegj,

---

<sup>36</sup> Ligji nr. 110/2018 “Për Noterinë”, neni 105, pika 3.

<sup>37</sup> Shih vendimin nr. 7, datë 16.01.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

<https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/vendimet-e-gjykates/vendimet-1999-2019>

balanca negative u zbut<sup>38</sup>, por mbetet gjithsesi e konsiderueshme. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit rezultoi me *mungesë* burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 4.380.892 lekë<sup>39</sup>, për krijimin e kësaj pasurie dhe përballimin e shpenzimeve të tjera familjare, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e subjektit, për të ardhura të konsiderueshme nga avokatia apo për kontribut të prindërve e të vëllait, u vlerësuan edhe në Kolegj të mbetura në nivel deklarativ e të pambështetura në dokumentacionin e kohës. Në vijim, analiza e detajuar e fakteve të rezultuara nga shqyrtimi i pretendimeve të subjektit.

#### *Analiza e pretendimeve për të ardhurat e subjektit nga avokatia*

11. Në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të provuar të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si avokat në vlerën 5.000.000 lekë, për periudhën 1993-1997, subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) ka ushtruar realisht këtë profesion; (ii) në kuptim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhurat e realizuara nga avokatia; (iii) referuar çështjeve të ngjashme<sup>40</sup>, i kërkon Kolegjit që për periudhën 01.06.1993 - dhjetor 1997, aktiviteti privat i avokatisë të konsiderohet si biznes i vogël, me vlerë qarkullimi vjetor prej 2.000.000 lekësh dhe marzhi vjetor i fitimit t’i përllogaritet në masën 80% për çdo vit të kësaj periudhe.

11.1. Në përgjigje të këtij grupi pretendimesh, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti dështoi të provonte të ardhurave të realizuara nga avokatia edhe në nivelin sasior, gjë që përjashton edhe teorikisht ligjshmërinë e tyre. Nga aktet në dosje, rezulton e provuar se në vitet 1993-1997 subjekti i rivlerësimit ka vepruar në cilësinë e mbrojtësit ligjor në disa procese gjyqësore penale, ndërsa ishte i punësuar si jurist në institucione shtetërore [pranë {\*\*\*} dhe {\*\*\*}]. Në konsideratë të këtij konstatimi, si dhe të faktit që institucionet e tjera konfirmojnë mungesë dokumentacioni provues për pagesat e detyrimeve financiare që shoqërojnë ushtrimin e këtij aktiviteti, si dhe ndalimit ligjor të dypunësimit për avokatët e licencuar, sipas ligjeve të kohës, nuk mund të argumentohet se subjekti gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhurat e pretenduara. Nga kjo analizë, deduktohet njëkohësisht që ato nuk përmbushin kriterin e ligjshmërisë, sikurse edhe janë tërësisht deklarative në aspektin sasior. Për pasojë, nën dritën e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, edhe në analizën e kryer në Kolegj, ky burim u konsiderua i paprovuar. Në vijim, shtjellohet analiza e Kolegjit, sipas shkaqeve të ankimit.

11.2. *Së pari*, pretendimi i subjektit se e ka ushtruar realisht profesionin e avokatit vlerësohet nga trupi gjykues i Kolegjit se është ngritur pa shkak. Komisioni<sup>41</sup> nuk ka vënë në dyshim faktin e ushtrimit të aktivitetit të avokatisë, por vetëm mungesën e dokumentacionit provues për të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga ky aktivitet. Nga ana tjetër, ndryshe nga sa pretendohet, subjekti

<sup>38</sup> Diferenca prej 193.498 lekësh, nga vlera e përllogaritur në Komisioni vjen si rezultat i përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për vitin 1998-1999 në masën 30% të të ardhurave.

<sup>39</sup> Mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën (-) 2.763.323 lekë deri në vitin 1999 dhe në vlerën (-) 1.617.569 lekë në vitin 2008.

<sup>40</sup> Subjekti i rivlerësimit citon vendimin e Kolegjit nr. 6(JR), datë 17.03.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit H. K..

<sup>41</sup> Në pikën 1.56 të vendimit objekt ankimi, Komisioni arsyetoi se shpjegimet e dhëna në prapësimet kundër rezultateve të hetimit dhe dokumentacioni shoqërues, i kanë krijuar bindjen se subjekti e ka ushtruar profesionin e avokatit.

nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive në kuptim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka dështuar të provojë ekzistencën e dokumenteve që dëshmojnë të ardhura faktike të realizuara nga ushtrimi i aktivitetit dhe derdhjen e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, e po ashtu edhe zhdukjen, humbjen dhe pamundësinë e ribërjes së dokumentit ose pamundësinë e marrjes së tij në rrugë tjetër. Ky vlerësim u bazua në situatën e rezultuar nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar me deklaratën *vetting*, shpjegimet e pyetësorit nr. 1, prapësimet kundër rezultateve të hetimit, por edhe në ankim, të cilat vërtetojnë faktin se subjekti është licencuar për ta ushtruar këtë aktivitet gjatë viteve 1993-1997, por jo të ardhura faktike të realizuara<sup>42</sup> e, për pasojë, as teorikisht nuk mund të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave nëpërmjet detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit. Edhe shkresa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, datë 30.01.2023 dhe procesverbali i dorëzimit të dosjeve të personave fizikë dhe regjistrave të personave fizikë në atë gjykatë për periudhën 1991 - 21.08.2007, vërteton faktin e pakontestuar që subjekti ka qenë i regjistruar si person fizik avokat [më datë 01.06.1993], por jo të ardhura të realizuara prej këtij aktiviteti.

**11.3.** Po ashtu, ndonëse në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura të *padokumentuara* nga avokatia në vlerën 5.000.000 lekë për periudhën 01.06.1993 - 30.11.1997, në deklarimin për herë të parë, në mars 2004 [për vitin 2003], nuk deklarohen të ardhura nga ky aktivitet. Në këtë deklaratë, subjekti herë përshkruan “kursime familjare” si burim krijimi për pasuritë dhe herë “të ardhura nga paga” si burim për gjendjen e *cash*-it në banesë.

**11.4.** Me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës të tjera dokumente të njehsuara me origjinalin, të analizuara më sipër<sup>43</sup>. Të tri këto akte nuk përbëjnë prova të reja në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, pasi subjekti nuk pretendon e as provon pamundësinë pa fajin e tij për paraqitjen e tyre në Komision dhe as pretendime me natyrë shkeljesh procedurale të kryera nga Komisioni, lidhur me disponimin për pranimin ose refuzim të tyre. E kundërta rezulton në ankim, ku subjekti pranon se i dispononte aktet në arkivën e tij personale. Edhe duke abstraguar nga ky konstatim, marrja e tyre është e panevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nuk provojnë asgjë në drejtim të të ardhurave. Këto akte vërtetojnë vetëm faktin e pakontestuar se subjekti ka qenë i regjistruar në këto organe, si person fizik avokat. Edhe dokumenti “Deklaratë për pagesën e sigurimeve shoqërore”, i cili është thjesht një vetëdeklarim i subjektit për vitin ushtrimor 01 qershor - 31 dhjetor 1993, se pranon të sigurohet mbi pagën fikse vjetore 18.000 lekë dhe nuk konfirmon derdhjen realisht të tyre. Ky akt vjen në kundërshtim me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2016, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Agjencia Mat, e cila konfirmon se subjekti është regjistruar pranë kësaj agjencie, por *nuk* ka derdhur kontribute për sigurime shoqërore.

**11.5.** Duke vijuar me panoramën e çfarë rezulton nga aktet, përpos shkresave më sipër për licencimin e subjektit si avokat, dy dokumentet e Bashkisë Mat, të lëshuara në shkurt dhe tetor

---

<sup>42</sup> Vërtetimi nr. {\*\*\*}, datë 22.02.2016, i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, bashkëlidhur të cilit gjendet edhe certifikata e titullit të avokatisë vërteton se në periudhën 1993-1997, subjekti ka ushtruar profesionin e avokatit pranë dhomës së avokatisë Dibër.

<sup>43</sup> Certifikatë ushtrimi profesioni lëshuar nga Zyra e Tatimeve të rrethit Mat, Burrel, certifikatë regjistrimi në organin tatimor, si person fizik, lëshuar nga Dega Tatim Taksa e rrethit Mat dhe deklaratë për pagesën e sigurimeve shoqërore.

2016, vërtetohet që subjekti i rivlerësimit ka qenë i punësuar *si jurist* pranë Bashkisë Burrel për periudhën nga 01.01.1993 deri 30.08.1995. Shkresa e lëshuar nga ISSh-ja Dibër, Agjencia Mat [nr. {\*\*\*} prot., datë 13.10.2016] dhe vërtetimi i po kësaj agjencie, konfirmojnë faktin se subjekti i rivlerësimit ka qenë *i punësuar* pranë {\*\*\*} në Burrel, e cila ka paguar kontributin e sigurimeve shoqërore për subjektin për periudhën 01.04.1997-31.12.1997. *Së fundmi*, shkresa e ISSh-së Dibër, Agjencia Mat, [nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2016], drejtuar subjektit të rivlerësimit, vërteton se në regjistrin e personave fizikë pranë kësaj agjencie, subjekti i rivlerësimit rezulton i regjistruar me një numër përkatës e datë fillimi 01.06.1993, për aktivitetin avokat, por edhe që *nuk* janë derdhur kontribute për sigurimet shoqërore.

**11.6.** Nga sa më sipër, deduktohet se ndonëse subjekti ka qenë i regjistruar si avokat prej vitit 1993, ai ishte i punësuar dhe i siguruar pranë ish- {\*\*\*} për periudhën 01.01.1993-30.08.1995 dhe pranë {\*\*\*} për periudhën 01.04.1997-31.12.1997. Rrjedhimisht, subjekti nuk mund të pretendojë të ardhura të realizuara nga avokatia për këto periudha.

**11.7.** Shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, e korrikut 2020 [nr. {\*\*\*} prot.], sipas së cilës nuk gjendet dokumentacion që konfirmon ushtrimin e aktivitetit tatimor nga subjekti si avokat për periudhën maj 1993 - nëntor 1997, ndonëse referon se një pjesë e dokumentacionit tatimor është shkatërruar gjatë trazirave të vitit 1997, është shumë e *përgjithshme* për të treguar pamundësinë objektive në një nivel që zhvlerëson sa rezulton nga gjithë aktet e tjera të analizuara më sipër. Konkretisht, kjo shkresë nuk përcakton nëse në mesin e informacionit përkatës, që ka humbur, gjenden edhe të dhënat për regjistrimin dhe shlyerjen e detyrimeve nga personat fizikë apo aktivitete të tjera në mesin e të cilëve mund të prezumohej të gjendej edhe dokumentacioni mbështetës për aktivitetin e ushtruar nga subjekti.

**11.8.** Me prapësimet kundër rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar akte gjyqësore<sup>44</sup>, nëpërmjet të cilave ai paraqitet si pjesëmarrës në disa procese gjyqësore penale<sup>45</sup>, në cilësinë e mbrojtësit ligjor të të pandehurve në vitet 1993-1997. Këto akte vërtetojnë në të njëjtën linjë me sa më sipër, që subjekti gjatë periudhës në fjalë ka përfaqësuar palë, por nuk vërtetojnë të ardhurat e realizuara dhe aq më pak ligjshmërinë e tyre në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Nga ana tjetër, në vitet 1993-1997, subjekti ka vepruar në cilësinë e mbrojtësit ligjor në procese gjyqësore penale, duke qenë njëkohësisht i punësuar si jurist në institucione shtetërore, konkretisht pranë {\*\*\*} dhe {\*\*\*}<sup>46</sup>. Fakti i dypunësimit është pranuar edhe nga vetë subjekti gjatë pyetjes në ILDKPKI, lidhur me burimin e krijimit të gjendjes *cash* prej 5.000.000 lekësh, kur është shprehur “*kam kryer edhe funksione pranë {\*\*\*}, duke qenë se në atë kohë ligji nuk e ndalonte dypunësimin*” gjatë kohës kur ishte i licencuar si avokat.

---

<sup>44</sup> Të përcjella subjektit nga institucione gjyqësore, shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 25.04.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. {\*\*\*} prot., datë 02.05.2023, të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor; nr. {\*\*\*} prot., datë 24.04.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

<sup>45</sup> Ndërkohë që subjekti ishte jurist i punësuar nga Bashkia Burrel, është paraqitur si përfaqësues ligjor: (i) procesin gjyqësor datë 25.08.1993; (ii) procesin gjyqësor datë 14.09.1993; (iii) procesin gjyqësor datë 01.04.1994; (iv) procesin gjyqësor datë 02.06.1994; (v) procesin gjyqësor datë 16.02.1995; (vi) procesin gjyqësor datë 09.06.1995 (16.01.1995 – 30.08.1995); (vii) procesin gjyqësor datë 12.09.1996; (viii) procesin gjyqësor datë 11.10.1996; dhe (ix) gjatë punësimit në {\*\*\*} në procesin gjyqësor datë 19.11.1997.

<sup>46</sup> {\*\*\*} ka qenë ndërmarrje shtetërore deri në vitin 2001 të dhënies në koncension, në bazë të ligjit nr. 8791/2001.

**11.9.** Pretendimi i sipërcituar është i pambështetur, pasi ligji nr. 7827/1994 „në fuqi në atë kohë<sup>47</sup>, në nenin 5 përcaktonte në mënyrë eksplicite, ndalimin e avokatëve për të ushtruar *veprimtari nëpunësie mbi bazën e marrëdhënieve të punës me shtetin*. Evidentimi i këtij ndalimi ligjor sillet në vëmendje vetëm si konfirmim i mungesës së besueshmërisë së shpjegimeve të tij për deklarinimin e të ardhurave pranë organeve përgjegjëse. Parë në këtë aspekt, trupi gjykues arsyeton se ndalimi i mësipërm ligjor duhet parë si shkak për të cilin subjekti *nuk* mund të gjendet në kushtet e pamundësisë objektive, pasi të ardhurat nga avokatia nuk mund të deklaroheshin në çfarëdo niveli sasior pasi për të njëjtën periudhë, institucionet publike [\*\*\*] dhe [\*\*\*] kanë deklaruar punësimin e subjektit dhe pagën e tij. Sa më sipër, është në linjë me konfirmimin e ISSh-së Dibër, në datën 26.10.2016, se subjekti *nuk* ka qenë subjekt tatimpagues si avokat. Për rrjedhojë, të ardhurat nga avokatia nuk janë deklaruar pranë organeve tatimore, edhe nëse ato kanë ekzistuar. Pjesëmarrja në procese gjyqësore në cilësinë e avokatit ka qenë një veprimtari dytësore, e cila, ndonëse mund të ketë gjeneruar të ardhura për subjektin, nuk mundëson përlllogaritje sasiore të tyre, përpos nivelit deklarativ e, për pasojë, përjashtohet mundësia e përmbushjes së kriterit të ligjshmërisë edhe parimisht. Për këto arsye, subjekti nuk gjendet në kushtet e pamundësisë objektive, sipas pretendimit, për shkak të mosgjetyes së dokumentacionit si rezultat i kohës së largët apo të shkatërrimit nga trazirat e vitit 1997.

**11.10.** Pretendimi i subjektit për ta konsideruar aktivitetin privat të avokatisë, të ushtruar në periudhën 01.06.1993 - dhjetor 1997, si biznes i vogël, me vlerë qarkullimi vjetor prej 2.000.000 lekësh dhe marzh vjetor fitimi prej 80% për çdo vit të kësaj periudhe kohore, vlerësohet i pambështetur në ligj e prova për vitet 1993, 1994, 1995 dhe 1997, në të cilat rezultoi i provuar punësimi i subjektit si jurist. Ndërsa për vitin 1996, përgjatë të cilit, referuar dokumentacionit nuk rezultoi i punësuar pranë institucioneve shtetërore, subjekti dështoi të provonte me dokumentacion qoftë vlerën e të ardhurave të realizuara nga avokatia, ashtu edhe derdhjen e kontributeve.

*Analiza e pretendimeve për kursimet familjare të prindërve dhe vëllait të tij si burim krijimi i pasurisë*

- 12.** Komisioni nuk ka pranuar në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti për ndërtesën objekt vlerësimi, kontributin e pretenduar nga kursimet familjare të prindërve dhe vëllait të tij, me argumentin se subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar këto kursime në deklaratën *vetting* apo në deklaratën periodike për vitin 2003, nuk ka përcaktuar vlerën e këtij kontributi dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për të ardhurat që kanë shërbyer si burim.

**12.1.** Subjekti kundërshton konkluzionin e mësipërm të Komisionit dhe i kërkon Kolegjit të marrë në konsideratë kursimet familjare të prindërve të tij dhe të vëllait, të krijuara përkatësisht me të ardhurat e prindërve nga pensionet dhe të ardhurat e të vëllait [z. S. H.], përgjatë viteve 1982-2001, nga punësimi në ish-\*\*\* dhe pranë \*\*\*. Subjekti kërkon të mbahet në konsideratë edhe fakti

---

<sup>47</sup> Ligji nr. 7827/1994 ka qenë në fuqi deri më datë 20.08.2003. Në nenin 5 të tij parashikohej: “Avokati nuk mund të jetë në të njëjtën kohë noter, të ushtrorë veprimtari tregtare në emër të tij ose në emër të tjerëve, të jetë përfaqësues i çdo lloji kulturi fetar, si dhe të ushtrorë veprimtari nëpunësie mbi bazën e marrëdhënieve të punës me shtetin, me përjashtim të veprimtarisë shkencore, artistike, letrare, arsimore e sportive.” Ky ligj është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9109/2003, i cili gjithashtu në nenin 16 pika 1, parashikon ndalimin e ushtrimit të profesionit të avokatit, për aq kohë sa është në marrëdhënie pune me administratën publike. Ky ndalim ligjor ka qenë i parashikuar edhe më herët, në nenin 13 të ligjit nr. 7541/1991.

që për periudhën 1991-1993, vëllai i tij ka realizuar të ardhura edhe nga aktiviteti privat tregtar si shitës ambulant në treg të lirë [shitës këpucësh], pavarësisht se subjekti nuk posedon dokumentacion provues.

**12.2.** Trupi gjykues i Kolegjit e gjeti jobindës pretendimin e subjektit se për krijimin e kësaj pasurie kanë kontribuar me kursimet e tyre prindërit dhe vëllai. Edhe në Kolegj u konfirmua që ky kontribut nuk ka gjetur pasqyrim as në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën *vetting*, por edhe nuk është specifikuar në vlerë e për sa i përket mënyrës sesi është dhënë. Po ashtu, subjekti dështoi të provonte me dokumentacion ekzistencën e të ardhurave të gjeneruara nga punësimi i të vëllait. Ky konkluzion bazohet në analizën që shtjellohet në vijim.

**12.3.** *Së pari*, në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën për herë të parë të pasurisë të vitit 2003, janë deklaruar si burime *shitja* e një apartamenti në Burrel dhe *kursimet* familjare të punës ndër vite, pa specifikuar origjinën dhe vlerën sasiore të tyre. Gjatë pyetjes në ILDKPKI, në shkurt 2016, subjekti ka deklaruar se bashkë me babain dhe vëllain kanë hedhur vetëm themelet për banesën 3 kate në vitin 1995, por nuk ka referuar kontributin financiar të tyre përpos këtij aspekti. Edhe në pyetësin standard, subjekti nuk ka referuar burimet financiare që kanë shërbyer për blerjen e truallit apo shpenzimet e tjera të kryera në periudhën kohore në fjalë<sup>48</sup>, dhe është specifikuar për herë të parë në përgjigje të pyetësit nr. 1, datë 01.02.2023 [ndonëse me kontradikta brenda të njëjtit pyetësor<sup>49</sup>]. Ky element ka pësuar ndryshim sërish në përgjigjet e datës 02.02.2023, ku subjekti citon si burim vetëm të ardhurat nga *puna e tij* si avokat e jurist.

**12.4.** *Së dyti*, sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, subjekti nuk ka referuar asnjëherë një vlerë konkrete të kontributit financiar të prindërve e vëllait dhe as ka depozituar dokumentacion justifikues për të provuar kursimet e tyre familjare. Deklarata e thjeshtë, datë 15.07.2020, e vëllait, fokusohet në të ardhurat nga shitja e banesës në Burrel, të cilat rezultojnë të pranuar nga Komisioni, referuar pikës 1.89 të vendimit objekt ankimi. Më tej, librezja e punës e vëllait, përveç të dhënave mbi punësimin, nuk përmban të dhëna mbi të ardhurat e realizuara gjatë këtyre viteve. Pretendimi se vëllai për periudhën 1991-1993 ka realizuar të ardhura edhe nga aktiviteti privat tregtar si shitës ambulant në treg të lirë mbetet në nivel deklarativ, për sa kohë ato nuk u provuan me dokumentacion as në plan ekzistencial edhe duke abstraguar nga plani i ligjshmërisë. *Së treti*, trupi gjykues vlerëson se babai i subjektit nuk mund të ketë kontribuar financiarisht në kushtet që banesa është ndërtuar në vitin 1999, një vit pas vdekjes së tij<sup>50</sup>.

**12.5.** *Së fundmi*, në përgjigjen nr. 3 të pyetësit standard<sup>51</sup>, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *de iure* ishte ndarë nga trangu familjar i origjinës më datë 20.01.2005, ndërsa në fakt, prej muajit janar 1999, ai ka jetuar në Tiranë i ndarë vetëm me familjen e tij të përbërë nga bashkëshortja dhe dy fëmijët. Nisur nga këto shpjegime, pretendimi për kontribut financiar të vëllait, duket i

---

<sup>48</sup> Në përgjigje të pyetësit standard të datës 05.08.2020, subjekti nuk ka deklaruar burime për blerjen e truallit, e hedhjen e themeleve dhe punimet për përfundimin e katit nëntokë e përdhe, ndërsa si burime për karabinanë e katit të dytë e të tretë ka deklaruar të ardhurat nga puna në emigracion të motrës dhe kunatit.

<sup>49</sup> Ndër burimet e cituara në përgjigjen nr. 2, subjekti deklaroi pa një vlerë konkrete edhe kursimet familjare të prindërve e vëllait, ndryshe nga përgjigja nr. 1 e të njëjtit pyetësor, ku nuk i specifikon fare këto kurse si burim për pasurinë në fjalë.

<sup>50</sup> Referuar shpjegimit në përgjigjet e pyetësit standard, se babai i subjektit ka ndërruar jetë më datë 04.01.1998.

<sup>51</sup> Përgjigjet e datës 05.08.2020.

palogjikshëm në kushtet kur ai jetonte i ndarë nga subjekti i rivlerësimit, duke mos pasur asnjë interes në banesën, e cila që prej krijimit e në vijim, posedohet vetëm prej subjektit të rivlerësimit.

**12.6.** Bazuar në situatën faktike të rezultuar nga verifikimi i pretendimeve si më lart arsyetuar, trupi gjykues kreu kontrollin e analizës financiare të Komisionit për këtë pasuri. Nga kjo analizë, edhe në Kolegj u konfirmua qëndrimi i Komisionit për periudhat dhe koston e ndërtimit, konsiderimin e të gjithë investimit të kryer me kontributin financiar vetëm të subjektit e, po ashtu, edhe për burimet për krijimin e pasurisë. Si përfundim, nga analiza financiare edhe në Kolegj, rezultoi se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë, në vlerën (-) 2.763.323 lekë deri në vitin 1999, në vlerën (-) 1.617.569 lekë në vitin 2008 dhe në total, pamjaftueshmëria financiare e subjektit për këtë pasuri rezultoi në vlerën (-) 4.380.892 lekë. Duke mbajtur në konsideratë sa është arsyetuar më sipër, për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të kohës së krijimit dhe deklarim të rremë në kushtet që, për efekt të përmirësimit të situatës së tij në kontrollin e pasurisë, ia ka atribuar një pjesë të konsiderueshme të investimit së motrës e familjarëve të saj, duke u gjendur në kuptim të germave “a”, “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

#### I. Gjendje cash në shumën 1.050.000 lekë

- 13.** Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë, në shumën 850.000 lekë, nga kursimet familjare të tij dhe të bashkëshortes ndër vite. Po aty, subjekti ka deklaruar shumën 200.000 lekë nga shitja e një automjeti, sipas kontratës së shitjes, datë 16.06.2016. Konstatohet se ndërsa kjo shumë deklarohet si e ardhur, ajo është përshkruar në të njëjtën qelizë me gjendjen e *cash*-it. Komisioni konkludoi se mënyra e deklarimit të subjektit në deklaratat periodike vjetore dhe në disa raste, edhe mungesa e këtij deklarimi, si dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në drejtim të shpjegimeve të dhëna, e bëjnë të pamundur kryerjen e kontrollit të plotë nga ana e Komisionit lidhur me këtë pasuri. Pasaktësitë në deklaratat e subjektit të rivlerësimit i krijuan bindjen se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**13.1.** Subjekti i rivlerësimit i konsideron të padrejta konkluzionet e mësipërme, duke pretenduar si vijon: (a) në deklarimin e gjendjes *cash* në banesë ka pasur parasysh shtesat e gjendjes së likuiditeteve të ndodhura në banesë dhe në llogari bankare siç konfirmohet edhe nga deklarimi në vitin 2015; (b) gjendja e *cash*-it në fund të vitit 2016 nuk ishte në shumën 5.700.000 lekë, sikurse e ka konstatuar gabimisht Komisioni. Kjo vlerë do të ishte mbi kufirin maksimal prej 1.500.000 lekësh të lejuar me ligj për likuiditetet jashtë sistemit bankar; (c) subjekti nuk ka kryer deklarim të pasaktë. Gjendja *cash* në banesë mund të jetë pakësuar gjatë vitit për shpenzime të ndryshme dhe mund të jetë shtuar nga arkëtimet nga pagat, ndër to edhe nga shitja e automjetit, por duke mos ndryshuar në fund të vitit në krahasim me vitin e kaluar. Gjendja *cash* në banesë nuk është një gjendje statike, ajo ndryshon me shpenzimet dhe arkëtimet gjatë vitit kalendarik.

**13.2.** Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë sa i përket gjendjes së likuiditeteve jashtë sistemit bankar [në *cash*] në deklaratën *vetting*. Konkluzioni

i Komisionit është i bazuar. Subjekti ka pretenduar vlera të ndryshme e ka pasur pretendime kontradiktore në procesin e rivlerësimit e në ILDKPKI, që e bëjnë të pamundur kontrollin e plotë të vlerës prej 1.050.000 lekësh të deklaruar prej tij në deklaratën *vetting*, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe përbën deklaram të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 të të njëjtit ligj. Ky vlerësim u bazua në faktet që rezultuan nga shqyrtimi i pretendimeve të subjektit, shtjelluar në vijim.

**13.3.** Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të pasurisë dhe aktet që administrohen në dosje, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti ka qenë kontradiktor lidhur me likuiditetet *cash* qoftë sa i përket vlerës, vendndodhjes (banesë/bankë), burimeve për krijimin e saj, si dhe ndryshimeve ndër vite. Konkretisht:

- a. në muajin mars 2004 [deklarata e parë sipas ligjit nr. 9049.2003], subjekti ka deklaruar 5.000.000 lekë, *cash* në banesë, me burim të ardhura nga paga;
- b. në vitet në vijim, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat në vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, dhe 2009, 2012, 2013 dhe 2014, ai ka deklaruar kursime, pa specifikuar vendndodhjen e tyre – jashtë sistemit bankar apo në bankë;
- c. Në deklaratën për vitin 2010, subjekti nuk ka referuar për ndryshime të *cash*-it, por ka deklaruar blerjen e një apartamenti për pagesat e të cilit janë përdorur dy hua, 14.000 + 27.000 euro dhe pjesa tjetër nga mbyllja e depozitës në bono thesari e bashkëshortes dhe gjendja në *cash* e akumuluar;
- d. në deklaratën për vitin 2011 nuk ka referencë për këtë zë;
- e. në deklaratën për vitin 2006 dhe 2015, subjekti ka deklaruar kursimet në përputhje me formularin, duke specifikuar *cash*-in në banesë dhe pjesën e depozituar në sistemin bankar;
- f. në deklaratën për vitin 2016, dorëzuar në datën 24.03.2017 [dy muaj pas dorëzimit të deklaratës *vetting*], subjekti nuk ka bërë deklarime për shtesa/pakësime/gjendje të likuiditeteve *cash*. Në pyetësin nr. 1, ka shpjeguar se gjendja e *cash*-it në banesë nuk ka ndryshuar.

**13.4.** Gjatë hetimit, në pyetësorë, Komisioni i ka kërkuar shpjegime për gjithë deklaratimet. Në përfundim, Komisioni i ka gjetur të pabazuara dhe nuk ka pranuar mënyrën e pretenduar prej subjektit në pyetësorë për vendndodhjen dhe gjendjen e *cash*-it, sipas shpjegimeve për vitet 2005, 2006 dhe 2014, ndërsa ka pranuar pretendimet për vitin 2010, duke mbajtur në konsideratë mandatpagesën, datë 15.05.2010, për këstin prej 5.000 eurosh dhe deklarimin se për pagesat e apartamentit, përveç huave dhe tërheqjes së vlerës së bonove, janë përdorur edhe likuiditetet e akumuluar *cash* në disa nga deklaratimet, e konkretisht për vitet 2004, 2007, 2008 dhe 2009. Për sa i përket vitit 2011, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se gjendja e *cash*-it ka qenë ajo e vitit pararendës.

**13.5.** I njëjti shpjegim ka vijuar edhe për vitin 2014, pasi për gjendjen e *cash*-it në fund të vitit, në pyetësor, subjekti ka pretenduar se është pakësuar për shkak të likuidimit të këstit prej 10.000 eurosh për blerje apartamenti në Tiranë, i cili në fakt është likuiduar në vitin 2014, pavarësisht se mandatpagesa mban datën 17.03.2016. Ky shpjegim, rezulton i pa pasqyruar në asnjë formë në deklaratën periodike të vitit 2014, në të cilën nuk ka asnjë gjurmë për pagesën e këtij kësti e, po kështu, vjen në kundërshtim edhe me mandatpagesën e këstit 10.000 euro, e cila rezulton të jetë

kryer më datë 17.03.2016 dhe jo në vitin 2014. Në këto kushte, vlerësohet i drejtë qëndrimi i Komisionit se likuiditeti prej 10.000 eurosh nuk mund të konsiderohet si pakësim i gjendjes *cash* në vitin 2014.

**13.6.** Nga sa më sipër konstatuar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit gjatë hetimit administrativ se në deklarin e likuiditeteve *cash*, ka pasur parasysh gjendjen *cash* në banesë dhe ato në depozita bankare, është i pabazuar në ligjin nr. 9049/2003, i cili në nenin 4 përcakton në mënyrë specifike detyrimin e subjekteve deklarues për të deklaruar qartë vlerën e likuiditeteve dhe vendndodhjen e tyre. Edhe subjekti rezulton të ketë qenë i qartë për mënyrën e deklaramit, sikurse rezulton nga deklaratat e tij e parë ku ka specifikuar llojin *cash* të likuiditetit, vendndodhjen e tij në banesë, si dhe burimin e krijimit të *ardhura nga paga*. Kontradiktat në deklarime kanë lindur gjatë hetimit administrativ, e konkretisht, në dy pyetësorë, në të cilët subjekti ka pretenduar se gjendja e *cash*-it në banesë në fund të vitit 2003 nuk ishte 5.000.000 lekë, por 2.150.000 lekë, ndërsa diferenca prej 2.850.000 lekësh ka qenë në bono thesari në emër të bashkëshortes dhe që ia atribuon këtë mospërputhje një konsulte me një ish-inspektor të ILDKPKI-së. Trupi gjykues vlerëson se pranimi nga Komisioni i pretendimit të subjektit mbi mënyrën e deklaramit të likuiditeteve në deklaratën e parë, një ndër deklaratat më të sakta të hartuara nga subjekti, duke e rillogaritur gjendjen e *cash*-it në shumën 2.150.000 lekë, duke u bazuar në shpjegimet e subjektit në pyetësor, është i pabazuar në ligj, në situatën faktike dhe në jurisprudencën e Kolegjit. Megjithatë, për garanci procedurale të subjektit të rivlerësimit, edhe në analizën e kryer në Kolegji u pranua e njëjta mënyrë përlllogaritje sikurse në Komision.

**13.7.** Subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor edhe për sa i përket burimeve që kanë shërbyer për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003. Konkretisht, në pyetësorin standard, përpos ndryshimit të vlerës së *cash*-it të disponuar në banesë, subjekti ka shtuar si burim krijimi edhe të ardhurat nga paga e bashkëshortes. Ky zë të ardhurash përbën ndryshim edhe nga deklaramet në datën 26.02.2016, në ILDKPKI. Më tej, në përgjigjet për pyetësorin nr. 1, subjekti ka shtuar edhe të ardhurat të tjera [nga shitja e shtëpisë në Burrell], ndonëse në deklarime të tjera këto të ardhura nuk mund të disponoheshin ende në vitin 2003, pasi kishte deklaruar se ishin përdorur për pasurinë godinë banimi në Shkozë, analizuar më sipër.

**13.8.** Subjekti ka qenë kontradiktor edhe në deklarin e likuiditeteve *cash* për vitet 2005, 2006, 2007, 2009, 2010 dhe 2014, pasi jo vetëm nuk ka referuar nëse ishin jashtë sistemit bankar, por nuk ka deklaruar as ndryshimet që kanë pësuar këto likuiditete. Komisioni ka mbajtur një qëndrim lehtësues ndaj subjektit, në kushtet që nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr.1, ka mundësuar rikonfigurimin e deklarimeve periodike vjetore, duke i lejuar subjektit të përcaktojë në mënyrë prapavepruese për çdo vit deklarimi shtesat/pakësimet dhe vendndodhjen e likuiditeteve [*cash* apo depozitë]. Pavarësisht nga kjo mundësi e ofruar, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë kontribuar më tej në krijimin e kontradiktave në kushtet që ai rezulton të ketë zgjedhur mënyra të ndryshme për të deklaruar likuiditetet jashtë sistemit bankar.

**13.9.** Trupi gjykues arriti në përfundimin se deklarimet dhe shpjegimet e subjektit nuk janë të besueshme si pasqyrim i së vërtetës, dhe se shpjegohen vetëm me nevojën e tij për të dokumentuar ato gjendje *cash*-i që ka menduar në fazën përkatëse në të cilën është gjendur se mund t'i justifikonte me burime financiare të ligjshme. Ky konstatim paraqet rëndësi për shkak të lidhjes së

drejtpërdrejtë me konkluzionet për pasuritë e tjera, të arsyetuara në vijim. Konkretisht, gjatë periudhës 2006 – 2010 [nga momenti i porositjes së apartamentit 95 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në vitin 2006, deri në deklarimin për herë të parë të kësaj pasurie në vitin 2010], subjekti *nuk* ka deklaruar as pagesat e *kësteve*, as *huat* e marra dhe as *pakësimet* e gjendjes *cash*, duke e vështirësuar në këtë drejtim kontrollin e këtyre likuiditeteve.

**13.10.** Në këto kushte, konstatimi i Komisionit<sup>52</sup>, për kontradiktat në deklarimin e likuiditeteve *cash* ndër vite, është i bazuar. Nga analiza e deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, kursimet *cash* në banesë do të përlllogariteshin në vlerën 2.897.343 lekë, në mospërputhje të dukshme me vlerën prej 1.050.000 lekësh të deklaruar në deklaratën *vetting*. Kjo situatë është versioni më i favorshëm për subjektin në kushtet që në analizën financiare, Komisioni ka pranuar si likuiditete *cash* për periudhën 1992-2003, vlerën 2.150.000 lekë dhe jo 5.000.000 lekë të deklaruar në deklaratën e parë të pasurisë. Për sa më sipër, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën *vetting*, në kuptim të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## *II. Pasuria apartament me sip. 95,26 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë*

- 14.** Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar bashkëpronësinë e tij, bashkëshortes dhe fëmijëve mbi një apartament 2+1, me sipërfaqe totale së bashku me shkallët prej 95,26 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, të porositur me kontratën noteriale të porosisë, datë 07.06.2006, kundrejt vlerës 74.000 euro. Burimet e krijimit të kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes ndër vite (1985-2006), si dhe dy hua të marra nga dy persona [z. K. D. dhe L. C..]

**14.1.** Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur përcaktimet e shkronjave “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ai ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare. Ky konstatim mbajti në konsideratë balancën negative të subjektit dhe personave të lidhur për: (i) kryerjen e shpenzimeve, investimin në bono thesari dhe shtesën në kursime, në vlerën 3.054.279 lekë, për periudhën 2000-2003; (ii) në vlerën 3.775.147 lekë për vitin 2006, për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve; (iii) në vlerën 1.337.908 lekë për shlyerjen e këstit prej 10.000 eurosh, në datën 17.03.2014, për blerjen e apartamentit në Tiranë. Ky konkluzion mban në konsideratë konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar porositjen e kësaj pasurie dhe detyrimet ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në deklaratat periodike të viteve përkatëse, sipas detyrimeve që ai mbartte si subjekt deklarues për shkak të ligjit nr. 9049/2003, deklarimet e subjektit në deklaratën për vitin 2010 se nuk ka pasur një kontratë me shkrim, nuk janë të vërteta, pasi kontrata e porosisë e vitit 2006 është lidhur përpara noterit publik dhe është nënshkruar nga personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit, në datën 07.06.2006 dhe për shkak të mungesës së besueshmërisë për marrjen realisht të dy huave deklaruar si burim për këtë pasuri.

**14.2.** Subjekti kundërshton në tërësi të gjitha konkluzionet e sipër referuara, duke potencuar se ka pasur burime të ligjshme për krijimin e pasurisë. Rezultati negativ financiar i konkluduar për këtë pasuri është rrjedhojë e vlerësimit të gabuar të Komisionit lidhur me burimet e përdorura për

<sup>52</sup> Referuar paragrafit 2.22, fq.37-38 si dhe konkluzionit përfundimtar fq.58, të vendimit të Komisionit.

krijimin e saj, me pasojë mospërfshirjen e tyre në analizën financiare të kryer për këtë pasuri. Subjekti kundërshton konkluzionet e mësipërme, duke potencuar se: (a) deklaratimet e dhëna prej tij në ILDKPKI dhe në Komision për dy huatë nuk janë kontradiktore; (b) huadhënësi K. D., me aktivitetin e tij tregtar ka pasur mundësi financiare, për të krijuar të ardhura, kursime dhe për të investuar në bono thesari. Dokumentacioni i administruar nga Banka e Shqipërisë, provon tërheqjen e bonove të thesarit prej tij; (c) huadhënësi tjetër, z. L. C., ka pasur mundësi financiare për të krijuar shumën e dhënë hua, me të ardhurat e ligjshme nga puna e tij prej 10 vitesh në emigracion.

**14.3.** Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit për mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie është i bazuar. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, subjekti rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme për të përballuar pagesën e këstit të parë, të dytë dhe të pestë, për shlyerjen e detyrimeve që i përkasin kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë e krijimit me burime të ligjshme të fondeve të investuara në vitet 2000-2004 në bono thesari, sikurse as edhe huadhëniet e pretenduara si burim i pjesshëm për krijimin e kësaj pasurie. Trupi gjykues konstatoi problematika të deklaratimeve të shprehura në forma të ndryshme si, mosdeklarim i kontratës së porosisë në vitin kur ka ndodhur veprimi juridik, por disa vite më vonë, mosdeklarim të pagesave të kryera dhe as të detyrimeve financiare ndaj shoqërisë ndërtuese. Këto problematika u vlerësuan në drejtim të besueshmërisë në tërësi të pretendimeve të subjektit për mënyrën e krijimit të kësaj pasurie. Arsytimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

**14.4.** Nga aktet në fashikullin e Komisionit, rezulton se apartamenti objekt vlerësimi është porositur me kontratën e porosisë të datës 07.06.2006, lidhur ndërmjet shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe bashkëshortes së subjektit kundrejt çmimit 74.000 euro. Porositja e apartamentit është deklaruar për herë të parë me deklaratën për vitin 2010, në mars 2011. Në këtë formular, subjekti deklaroi apartamentin në pronësi individuale (100%) të bashkëshortes dhe me kontratën e porosisë datë 07.06.2006. Subjekti ka deklaruar edhe kalendarin e pagesave. Sipas tij, në vitin 2006 është likuiduar shuma 47.500 euro, ndërsa në vitet në vazhdim, deri në vitin 2009 është paguar shuma 12.500 euro. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka referuar burimet e përdorura për këto pagesa: dy hua në shumat 14.000 euro dhe 27.000 euro, ndërsa pjesa tjetër nga mbyllja e depozitës në bono thesari e bashkëshortes dhe gjendja *cash* e akumuluar. Subjekti ka deklaruar edhe detyrimin e mbetur pa shlyer ndaj shoqërisë së ndërtimit në shumën 10.000 euro dhe dy hua, përkatësisht në shumën 14.000 euro marrë z. L. C. [i afërm i subjektit] dhe 27.000 euro marrë z. K. D. [kunati i subjektit]. Po në këtë rubrikë, subjekti ka sqaruar se mosdeklarimi i apartamentit të porositur është pasojë e mosmarrëveshjeve me firmën e ndërtimit dhe mosdhënies nga ana e saj, të një kontrate me shkrim.

**14.5.** Në kushtet që bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontratë noteriale porosie më datë 07.06.2006 me shoqërinë ndërtuese, konstatimi i Komisionit është i bazuar. Pretendimet e subjektit në deklaratën periodike të vitit 2010 dhe në prapësim të rezultateve të hetimit për mosdeklarim në kohë të marrjes përsipër të këtij detyrimi për shkak mos pasjes së një kontrate apo mosmarrëveshjes me shoqërinë ndërtuese, rezulton i pavërtetë. Po kështu, subjekti nuk ka deklaruar në vitet përkatëse dhe as në 2016 as pagesat e pretenduara dhe as detyrimet ndaj

shoqërisë ndërtuese në këto vite, ndërsa ka qenë evaziv në deklaratën periodike të vitit 2010, pavarësisht detyrimeve që kishte si subjekt deklarues.

**14.6.** Subjekti ka qenë kontradiktor edhe për kohën e shlyerjes së çmimit, në kushtet që shpjegimet në ILDKPKI, në shkurt 2016, bien ndesh me kontratën e porosisë, me vërtetimin e lëshuar nga shoqëria ndërtuese [që mban datën 25.02.2016] e me pyetësonin standard, në të cilin subjekti ka shtrirë periudhat e likuidimit të çmimit deri në vitin 2016, ndërkohë që kontrata noteriale e porosisë dhe deklaramet e mëparshme referonin si limit kohor fundor, përkatësisht vitin 2006 dhe vitin 2014.

**14.7.** Konkretisht, ndërsa sipas kontratës së porosisë<sup>53</sup>, çmimi prej 74.000 eurosh do të paguhej me 3 këste dhe likuidimi i tij do të përfundonte brenda datës 30.10.2006, sipas shpjegimit në ILDKPKI<sup>54</sup>, likuidimi i çmimit është shtrirë deri në vitin 2014, sipas një vërtetimi, datë 25.02.2016, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, ndonëse në atë vërtetim referohet vetëm likuidimi i vlerës 73.000 euro, por pa specifikuar numër këstesh, kalendar pagesash apo mandate. Ndërsa në përgjigje të pyetësonit standard<sup>55</sup>, subjekti prezanton për herë të parë, një kalendar pagesash prej pesë këstesh të shlyera gjatë harkut kohor 07.06.2006 - 17.03.2016, në kundërshtim me sa kishte deklaruar një muaj më herët në ILDKPKI se i gjithë detyrimi ndaj shoqërisë “Peza” ShPK ishte shlyer deri në vitin 2014. Më tej, në përgjigje të pyetësonit nr. 1<sup>56</sup>, subjekti ndryshon sërish qëndrimin në lidhje me vlerën 10.000 euro, e cila, sipas subjektit, është likuiduar në vitin 2014, pavarësisht se në mandatarkëtim është shënuar data 17.03.2016.

**14.8.** Pretendimi se mosdeklarimi i detyrimit ndaj shoqërisë ndërtuese nuk duhet të jetë penalizues, meqenëse në shkurt 2016 subjekti ka deklaruar në ILDKPKI shlyerjen e gjithë detyrimit në vitin 2014, është i pakuptimtë nën dritën e kontekstit të sipëranalizuar për mungesën e besueshmërisë. Objekt kontrolli për efekt të procesit të rivlerësimit është deklarata *vetting*, ndërsa deklaratat periodike vjetore verifikohen si mjet krahasimi që gjatë këtij procesi shërben për të ndjekur ecurinë

---

<sup>53</sup> Sipas kontratës së porosisë datë 07.06.2006, çmimi i apartamentit prej 74.000 eurosh, do të likuidohet brenda vitit 2006 me tre këste e konkretisht: (i) kësti i parë prej 47.500 eurosh u pagua jashtë zyrës noteriale, në momentin e nënshkrimit të kontratës; (ii) kësti i dytë prej 20.000 eurosh do të paguhet deri në datën 30.09.2006; (iii) kësti i tretë prej 6.500 eurosh do të paguhet deri në datën 30.10.2006, moment në të cilin do të dorëzohen çelësat në dorë, sipas një procesverbali të mbajtur mes palëve.

<sup>54</sup> Në datën 26.02.2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në ILDKPKI se gjatë periudhës 2006 - 2014 shuma 73.000 është shlyer i gjithë detyrimi ndaj shoqërisë. Subjekti ka paraqitur pranë këtij institucioni vërtetimin datë 25.02.2016 lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, sipas të cilit, bashkëshortja e tij, mbi bazën e kontratës së porosisë datë 07.06.2006, ka kryer pagesën e apartamentit në shumën 73.000 euro, gjatë periudhës kohore 2006 - 2014.

<sup>55</sup> Në përgjigje të pyetësonit standard, subjekti ka deklaruar se ndonëse kontrata e sipërmarrjes parashikonte se të tria këstet do të paguheshin brenda vitit 2006, në fakt, gjatë këtij viti është paguar vetëm kësti i parë në datën 07.06.2006, në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes. Pagesa e kësteve të tjera është realizuar në vitet pasardhëse, me mirëkuptimin e përfaqësuesit të firmës së ndërtimit, duke e lejuar që pagesat të kryheshin sipas mundësive financiare. Pagesat për apartamentin janë kryer me pesë këste, kronologjikisht: (i) shuma 47.500 euro, më datë 07.06.2006; (ii) shuma 12.000 euro, më datë 19.02.2007; (iii) shuma 500 euro, më datë 08.04.2009; (iv) shuma 4.000 euro paguar më datë 15.05.2010; (v) shuma 10.000 euro, më datë 17.03.2016. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur katër mandat-pagesa [datë 19.02.2007 me vlerë 12.000 euro; datë 08.04.2009 me vlerë 500 euro; datë 15.05.2010, vlerë 4.000 euro dhe datë 17.03.2016 me vlerë 10.000 euro], ndërsa nuk ka paraqitur mandat për shumën 47.500 euro të paguar më datë 07.06.2006, në momentin e nënshkrimit të kontratës jashtë zyrës noteriale.

<sup>56</sup> Në përgjigjet e datës 14.02.2023 në lidhje me mospërputhjet e konstatuara për pagesat, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, në vitin 2010, është kryer pagesa prej 4.000 eurosh, të cilën subjekti ka harruar ta deklarojë në DIPP-në e viteve 2010-2015. Ndërsa vlera 10.000 euro është likuiduar në vitin 2014, pavarësisht se në mandatin e arkëtimit është shënuar data 17.03.2016.

dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit e saktësinë e deklarimeve të tij. Në rrethanat konkrete, deklaratat periodike, së bashku me provat e tjera, u vlerësuan në tërësi me rrethanat e çështjes. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratat e interesave private periodike, parë në raport me përgjegjësinë që kanë subjektet deklaruese për të përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049/2003, mospërputhjet sistematike në deklaratën *vetting*, deklaratat periodike dhe shpjegimet e subjektit për këtë apartament, mbështesin përfundimin e Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm, referuar përcaktimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Sa më sipër, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në ligj.

**14.9.** *Së fundmi*, në të njëjtin kontekst, trupi gjykues i vlerësoi në drejtim të mungesës së besueshmërisë edhe problematikat që paraqesin mandatpagesat e depozituara nga subjekti kundrejt shlyerjes së çmimit të kësaj pasurie. Këto akte, rezultojnë me probleme të formës, pasi nuk janë hartuar në përputhje me legjislacionin që rregullon kontabilitetin, duke çuar, për rrjedhojë, në konstatimin se mandatpagesat janë të parregullta edhe duke abstraguuar nga fakti që nuk përputhen me kontratën e shitblerjes, sipas së cilës çmimi i blerjes duhet të likuidohej totalisht brenda vitit 2006. Në kushtet që Komisioni i ka pranuar këto akte, në mënyrë të pabazuar, për garanci procedurale të subjektit, edhe në analizën e kryer në Kolegj, ato u morën në konsideratë në funksion të kontrollit të analizës financiare.

**14.10.** Komisioni ka arsyetuar se nuk i ka gjetur të vërteta deklaratimet e subjektit për marrjen e dy huave, në kushtet që: (i) ato nuk janë deklaruar në vitin 2006, kur pretendohet të jenë marrë, por në vitin 2010; (ii) subjekti nuk provoi kohën reale të marrjes së tyre; (iii) subjekti ka bërë deklarime kontradiktore lidhur me kohën e marrjes së këtyre huave në deklaratën *vetting*, në pyetësonin standard dhe në vërtetimin e nënshkrimit para noterit publik; (iv) në deklaratat periodike të viteve 2006 – 2010, subjekti nuk ka deklaruar as detyrimin e tij financiar kundrejt huadhënësve; (v) huadhënësit rezultuan me mungesë burimesh të ligjshme financiare, për dhënien e huave. Bazuar në këto konkluzione, Komisioni nuk i përfshiu këto hua si burime të ligjshme në analizën financiare për pasurinë apartament objekt kontrolli.

**14.11.** Trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar analizën e Komisionit për deklarime kontradiktore, të cilat vënë në dyshim ekzistencën e huave, me të njëjtin arsyetim. Edhe në vlerësimin e Kolegjit, subjekti rezultoi i pabesueshëm, në kushtet që ai ka qenë kontradiktor për *kohën* e marrjes së tyre, *nuk* i ka deklaruar dhe as dokumentuar me akte të kohës këto veprime, por vetëm në mënyrë prapavepruese. Po ashtu, aktet janë shkresa të thjeshta, *pa* datë specifike, vërtetuar vetëm për nënshkrimin përpara një noterit publik vite më pas, e së fundmi që ka mungesë gjurmësh të kohës për shlyerjen e huave. Po ashtu, subjekti nuk provoi burimet e ligjshme të disponuara në kohën e dhënies së huave dhe as sasinë e pretenduar të dhënë në formën e huasë nga dy personat e tjerë të lidhur, përkatësisht në shumat 27.000 euro dhe 14.000 euro. Ky vlerësim u bazua në situatën faktike që rezultoi nga shqyrtimi i akteve në dosjen e Komisionit, shtjelluar në vijim.

*a. Huaja 27.000 euro nga kunati*

**14.12.** Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se huaja prej 27.000 eurosh është marrë në periudhën qershor - tetor 2006, sipas një deklarate me shkrim. Subjekti ka depozituar edhe një

deklaratë të thjeshtë (jonoteriale), datë 24.01.2017, të lëshuar nga huadhënësi [z. K. D.], i cili deklaroi se në vitin 2006 i ka dhënë atij një hua pa afat në vlerën 27.000 euro, shumë e cila rrjedh nga të ardhurat e biznesit të tij 20-vjeçar, depo farmaceutike “{\*\*\*}” ShPK. Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se shumë prej 20.000 eurosh të huas në fjalë e ka marrë në fillim të muajit qershor, ndërsa shumë 7.000 euro e ka marrë në muajin tetor 2006. Ky deklarim bie ndesh me deklaratën me shkrim dore në të cilën palët (dhënësi dhe marrësi i huasë) deklarojnë bashkërisht se u dha hua shuma 27.000 euro. Ky deklarim, i cili mban datën qershor 2006, përjashton çdo argument për shtrirjen në kohë përtej muajit qershor 2006.

**14.13.** Për më tepër, sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, huaja në fjalë është deklaruar për herë të parë në deklaratën për vitin 2010, vit në të cilin është deklaruar edhe apartamenti. Në këtë formular, subjekti ka deklaruar se huaja ka shërbyer si një ndër burimet për shlyerjen e këstit të parë prej 47.500 eurosh të paguar në vitin 2006. Referuar kontratës së porosisë, rezultoi se kësti prej 47.500 eurosh është likuiduar në datën 07.06.2006, në momentin e nënshkrimit të kontratës. Pra, në një lexim logjik e sistematik të këtyre dy akteve, kjo hua prezumohet të jetë marrë deri në datën 07.06.2006 dhe jo në muajt qershor - tetor 2006, referuar deklaratimeve të mëvonshme nëpër pyetësorë.

**14.14.** Referuar procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI-ja mbi arsyen e deklarimit të huas, katër (4) vite pasi deklarohet të jetë marrë, subjekti nuk ka dhënë shpjegim dhe ka depozituar vetëm një deklaratë të thjeshtë me shkrim dore, në të cilën është vendosur si datë muaji qershor 2006. Në këtë shkresë, huadhënësi i pretenduar/kunati i subjektit konfirmon përmbajtjen e deklaratimeve të subjektit. Kjo deklaratë paraqet probleme të besueshmërisë, pasi është pretenduar se është hartuar në vitin 2006, ndërsa vërtetimi i nënshkrimit tek noteri<sup>57</sup> është kryer në vitin 2010. Probleme të besueshmërisë rezultuan edhe sa i përket kthimit të shumave huadhënësit. Në deklaratën *vetting* dhe DIPP-të e viteve 2011-2016, subjekti ka deklaruar kthimin me disa këste të një pjese të huasë<sup>58</sup>, pa e shoqëruar me dokumentacion të kohës që të provojë çfarë deklarohet. Këto aspekte si dhe mospërputhjet në deklarime për kohën ekzakte kur është marrë huaja, edhe në vlerësimin e Kolegjit vënë në dyshim ekzistencën e huasë.

**14.15.** Për sa i përket burimeve të ligjshme të disponuara nga huadhënësi nëpërmjet aktivitetit të tij tregtar, pretendimet e subjektit nuk gjejnë mbështetje në prova, në linjë me analizën e kryer nga Kolegji e pasqyruar në vendime të mëparshme<sup>59</sup>. Konkretisht, me deklaratën *vetting*, subjekti ka depozituar një deklaratë të thjeshtë të datës 24.01.2017, në të cilën huadhënësi ka deklaruar se shuma prej 27.000 eurosh, dhënë hua në vitin 2006, rrjedh nga të ardhurat e biznesit të tij 20-vjeçar në shpërndarjen e barnave/produkteve farmaceutike. Subjekti ka dorëzuar edhe një ekstrakt historik të shoqërisë në fjalë [“{\*\*\*}” ShPK]. Gjatë pyetjes në ILDKPKI, subjekti ka depozituar edhe një vërtetim të datës 24.02.2016 të nënshkruar nga huadhënësi në emër dhe si përfaqësues i

<sup>57</sup> Me anë të vërtetimit-nënshkrimit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.12.2010, hartuar para noterit publik A. P., subjekti dhe z. K. D. deklarojnë se kjo deklaratë është redaktuar dhe nënshkruar prej tyre në qershor 2006, jashtë zyrës noteriale, dhe se ajo shpreh vullnetin e tyre të plotë.

<sup>58</sup> Në deklaratat periodike për vitet 2011-2016, subjekti ka referuar përkatësisht: (i) për vitin 2011, shlyerje 100.000 lekë dhe mbetje 26.000 euro; (ii) për 2012, shlyerje 1.000 euro dhe mbetje 25.000 euro; (iii) për 2013, shlyerje 300 euro dhe mbetje 25.000 euro; (iv) për 2015, shlyerje 1.000 euro dhe mbetje 24.000 euro; (v) për 2016, shlyerje 500 euro dhe mbetje 23.500 euro

<sup>59</sup> Vendimi nr. 16, datë 13.07.2020, paragrafi 15.11, që i përket subjektit H. D..

personit juridik në fjalë, në të cilin referohet se huaja e dhënë subjektit, rrjedh nga të ardhurat e biznesit.

**14.16.** Në përgjigje të kërkesës së Komisionit<sup>60</sup>, për të depozituar dokumentacion ligjor provues lidhur me shumën e dividendit të tërhequr, subjekti ka deklaruar se ai, huadhënësi, *nuk* ka tërhequr dividend nga biznesi dhe se të ardhurat që kanë shërbyer për hua, nuk kanë qenë vetëm nga biznesi, por edhe nga të ardhurat dhe kursimet e tij *familjare e personale*, kryesisht nga investimi i tij në bono thesari në vitet 2000 - 2005<sup>61</sup>. Nëpërmjet këtyre përgjigjeve, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklaratimet e bëra më herët në deklaratën *vetting* dhe në ILDKPKI, në kushtet që tashmë janë shtuar si burim krijimi të huas edhe të ardhurat nga kursimet familjare e personale të huadhënësit, nga investimi i tij në bono thesari. Ky deklaram, përveçse kontradiktor me deklaratimet më të hershme, vjen në kundërshtim edhe me vërtetimin e datës 24.02.2016, dorëzuar në ILDKPKI, ku vetë huadhënësi/kunati ka deklaruar vetëm të ardhurat e biznesit si burim krijimi të huas.

**14.17.** Sipas informacionit të dërguar në ILDKPKI nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve<sup>62</sup>, rezulton se kunati i subjektit ka qenë administrator/aksioner i dy subjekteve tregtare<sup>63</sup>. Nga këto akte, vihet re qartazi që të ardhurat e tërhequra dhe dividendi fillojnë nga viti 2009, kohë pasi është dhënë huaja në vitin 2006. Për rrjedhojë, prej tyre nuk rezultojnë të ardhura të huadhënësit nga kjo veprimtari tregtare, të cilat do të ishin relevante për dhënien e huas. Konkretisht, DRT-ja Dibër ka përcjellë informacionin për këtë individ, të regjistruar edhe si person fizik me veprimtari që lidhen me praktikë mjekësore dhe të dhëna të qarkullimit vjetor dhe fitimit për vitet 2013-2016. DRT-ja Dibër, po ashtu, ka konfirmuar se në vitet 2009 – 2012 ky subjekt rezulton me të ardhura 0 (zero) lekë. Sipas shkresës, subjekti tregtar nuk ka dividend të tërhequr këto vite. Po aty, DRT-ja Dibër ka vënë në dispozicion edhe informacionin për një prej personave juridikë ku huadhënësi ka qenë administrator/aksioner [{"\*\*\*"} ShPK]. Nga të dhënat mbi qarkullimin vjetor për vitin 2009 ky subjekt rezulton me 0 (zero) lekë qarkullim dhe fitimin e dividendit të tërhequr për vitet 2014-2016, në vlerat përkatëse.

**14.18.** DRT-ja Dibër, po ashtu, ka informuar Komisionin<sup>64</sup> se nuk ka të dhëna për periudhat 1996 – 2007 për të ardhurat dhe fitimet e subjektit tregtar të referuar si burim për krijimin e të ardhurave që kanë ushqyer huan [{"\*\*\*"} ShPK]. Pas kërkesës së Komisionit për një verifikim të dytë në arkivin fizike për periudhën 1996 - 2007, ky institucion ka konfirmuar<sup>65</sup> se qoftë në sistemin C@TS apo edhe në Zyrën e Protokoll Arkivit, nuk ka të dhëna për periudhat 1996 - 2007 për këtë subjekt tregtar. *Së fundmi*, ekstrakti i QKB-së tregon që kunati i subjektit ka zotëruar vetëm 16.66% të kuotave në këtë shoqëri gjatë periudhës 11.04.1995 - 24.02.2010. Ndërsa subjekti tregtar/person fizik në emër të tij rezulton të jetë regjistruar në datën 08.10.2009 ose disa vite pasi deklarohet të

<sup>60</sup> Pyetja nr. 3.2 e pyetësorit nr. 1.

<sup>61</sup> Subjekti ka paraqitur certifikatë vdekjeje të kumatit, dokument nxjerrje llogarie nga Banka e Shqipërisë dhe dokument për veprime të kryera për bonot e thesarit prej tij në vitet 2003 – 2004.

<sup>62</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 04.08.2017.

<sup>63</sup> Përkatësisht, Aktivitete të praktikës mjekësore, ambulatore, me NIPT {\*\*\*} dhe {\*\*\*} ShPK apo {\*\*\*} ShPK, me NIPT {\*\*\*}.

<sup>64</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 07.12.2022.

<sup>65</sup> Me anë të shkresës {\*\*\*} prot., datë 16.03.2023.

jetë dhënë huaja në qershor 2006. Për rrjedhojë, edhe nëse kanë ekzistuar, të ardhurat nga ky aktivitet nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e shumës 27.000 euro hua.

**14.19.** Për sa më sipër, njëjtë si Komisioni, edhe trupi gjykues i Kolegjit vëren se i kunati i subjektit ka zhvilluar aktivitet tregtar, por nuk provohet të ketë përfituar dividend përpara vitit 2006, ndërsa personi fizik në emër të tij, rezulton të jetë regjistruar pas kohës kur është dhënë huaja. Për rrjedhojë, të ardhurat nga ky aktivitet, edhe nëse kanë ekzistuar, nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e shumës 27.000 euro të dhënë hua. Referuar jurisprudencës së Kolegjit,<sup>66</sup> vetëm fakti i pasjes së një aktiviteti tregtar dhe gjendjes së likuiditeteve në sistemin bankar, nuk mjaftojnë për të konkluduar se edhe shuma e dhënë hua, ka doemos një burim të ligjshëm, ndërkohë që nga të dhënat e deklaruara në organet përkatëse nuk evidentohen rekorde të fitimit drejtpërdrejt të këtyre të ardhurave nga huadhënësi/personi tjetër i lidhur.

**14.20.** Pretendimi i subjektit për pamundësi objektive për sigurimin e dokumentacionit vlerësohet i pambështetur në korrespondencën shkresore të zhvilluar ndërmjet Komisionit dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, e cila ka konfirmuar vetëm mospasjen e të dhënave për këtë subjekt për periudhën e kërkuar 1996 - 2007, por në asnjë formë nuk referon problematika, të cilat mund të mbështesnin pretendimin e subjektit për pamundësinë objektive të sigurimit të informacionit. Nga ana tjetër, aktet e depozituara në Kolegj me parashtrimet shtesë, sikurse arsyetuar gjerësisht më sipër, edhe duke abstraguuar nga mungesa e kritereve ligjore për pranimin e provave të reja, nuk provojnë të ardhura/fitime personale të huadhënësit, por rimbursime të kryera në emër të shoqërisë tregtare, e cila ka edhe ortakë të tjerë.

**14.21.** Trupi gjykues e vlerëson të pambështetur në akte edhe pretendimin se huadhënësi kishte gjendje *cash* nga bonot e thesarit, të tërhequra në vitin 2004, të cilat, përpos të tjerash, janë sjellë si burim krijimi i huas vetëm në përgjigje të pyetësorit nr.1, në kontradiktë me deklaratimet më të hershme në ILDKPKI dhe me vërtetimin e datës 24.02.2016 dorëzuar në ILDKPKI, ku vetë huadhënësi deklaron si burim krijimi të huas, vetëm të ardhurat e biznesit të tij mbi 20-vjeçar, “{\*\*\*}”. Shtimi i këtij burimi gjatë hetimit administrativ bie ndesh edhe me përmbajtjen e deklaratës së huadhënësit në datën 24.01.2017 dhe në vërtetimin e datës 24.02.2016”, sipas së cilave huaja e dhënë subjektit, rrjedh nga të ardhurat e biznesit të tij. Aktet bankare të kunatit, për periudhën 03.01.2000 - 31.12.2005, sipas së cilave rezulton se ai ka investuar në bono thesari një shumë të konsiderueshme në datën 21.01.2003 dhe e ka tërhequr në datën 22.01.2004, përpos që, gjithsesi, nuk mund të zhbëjnë faktin që këto fonde nuk janë deklaruar se kanë ushqyer huan nga vetë huadhënësi e bëjnë pretendimin e subjektit të pabesueshëm, edhe nën dritën e faktit që nuk ka asnjë gjurmë që të ardhurat e tërhequra nga bonot e thesarit në vitin 2004, ishin mbartur si gjendje *cash* deri në vitin 2006 të dhënies së huas.

**14.22.** Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në kushtet që nuk provohen të ardhurat e fituara nga aktiviteti privat i huadhënësit e, po ashtu, likuiditetet financiare të tërhequra nga huadhënësi nuk janë deklaruar si burim krijimi i huas, pretendimi i subjektit për disponimin e kësaj shume nga huaja në mesin e burimeve që kanë shërbyer për pagesën e apartamentit është i pabesueshëm. Për rrjedhojë, edhe në Kolegj, sikurse në Komision, vlera e huas 27.000 euro nuk u

---

<sup>66</sup> Vendimi nr. 16-2020 (JR), 13.07.2020 paragrafi 15.12, që i përket subjektit të rivlerësimit H. D..

përfshi në mesin e burimeve të ligjshme në analizën financiare për pasurinë apartament objekt kontrolli.

b. *Huaja 14.000 euro marrë nga z. L. C.*

**14.23.** Arsyetimi i mësipërm për huan e parë deklaruar si burimi krijimi për këtë pasuri, gjen zbatim në tërësi edhe për huan e dytë. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se deklaratimet pranë ILDKPKI-së dhe në Komision nuk janë kontradiktore. Në mënyrë të përmbledhur dhe pa përsëritur sa është thënë më lart, trupi gjykues konstaton se: (i) nga leximi logjik e harmonik i deklaratës për vitin 2010 dhe i kontratës së porosisë së apartamentit, kjo hua që shërbeu për likuidimin e kështit të parë të apartamentit, prezumohet të jetë marrë përpara datës 07.06.2006 të pagesës në fjalë dhe jo gjatë periudhës qershor - shtator 2006 të referuar në deklaratën *vetting* e në përgjigje të pyetësorit standard; (ii) ajo nuk është deklaruar në deklaratën për vitin 2006, kur pretendohet të jetë marrë, por deklarohet për herë të parë në mars 2011, me deklaratën për vitin 2010; (iii) deklarata e thjeshtë e hartuar me shkrim dore, që mban datën qershor 2006, ndërsa vërtetimi i nënshkrimit të noteri bëhet në vitin 2010, për shkak të problemeve të formës dhe të besueshmërisë, përjashton edhe çdo argument për shtrirjen e huas përtej muajit qershor 2006. Pretendimi i subjektit se dhënia e huas ka vijuar deri në shtator 2006 bie ndesh edhe me deklaratën me shkrim dore në të cilën vetë nënshkruesit (dhënësi dhe marrësi i huasë), deklarojnë bashkërisht se u dha hua shuma 14.000 euro. Ky deklaram, i cili pretendohet të jetë kryer në muajin qershor 2006 e referon dhënien e shumës 14.000 euro, përjashton në vetvete pretendimin se huaja në fakt u dha në dy këste, respektivisht 8.000 euro në qershor 2006 dhe 6.000 euro në shtator 2006; (iv) probleme të besueshmërisë rezultuan edhe sa i përket kthimit të shumave huadhënësit. Në deklaratën *vetting* dhe deklaratat periodike të viteve 2011-2016, subjekti vetëm ka bërë deklarime mbi kthimin me disa këste të një pjese të huasë<sup>67</sup>, por pa e shoqëruar me dokumentacion të kohës që të provojë kthimin e shumave; (v) shpjegimi në pyetësorin standard se në muajin mars 2006, subjekti i kishte dhënë hua 16.000 euro kumatës së tij [znj. Sh. Gj.], e bën edhe më të pabesueshëm marrjen e huave në qershor 2006. Në konkluzion të sa më sipër, për rrjedhojë të mungesës së besueshmërisë për marrjen dhe kthimin e huas, vënë në dyshim ekzistencën e saj.

**14.24.** I pambështetur në prova u vlerësua edhe pretendimi se huadhënësi ka pasur mundësi financiare për të krijuar shumën e dhënë hua, me të ardhurat e ligjshme nga puna e tij prej 10 vitesh në emigracion. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj mbi bazën e dokumentacionit të administruar në Komision dhe llogaritja e shpenzimeve të jetesës, sipas EUROSTAT-it, rezultoi se të ardhurat *bruto* të personit tjetër të lidhur me subjektin/huadhënësit nuk kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të jetesës e, për rrjedhojë, as për krijimin e shumës 14.000 euro të dhënë hua, sipas pretendimit. Ky vlerësim mban në konsideratë që me deklaratën *vetting*, subjekti ka dorëzuar një deklaratë të thjeshtë, datë 24.01.2017, të lëshuar nga z. L. C., i

---

<sup>67</sup> Në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar se nga huaja prej 14.000 euro, pa afat shlyerje dhe pa interesa, është shlyer shuma 4.000 euro, duke mbetur pa shlyer shuma 10.000 euro. Në DIPP-të 2011-2016, subjekti ka bërë deklaratimet si vijon: (i) në DIPP/2011, shlyerje 200.000 lekë dhe mbetje 12.500 euro; (ii) në DIPP/2012, shlyerje 500 euro dhe mbetje 12.000 euro; (iii) në DIPP/2014, shlyerje 1.000 euro dhe mbetje 11.000 euro; (iv) në DIPP/2015, shlyerje 1.000 euro dhe mbetje 10.000 euro.

cili deklaron se në vitin 2006 i ka dhënë një hua pa afat në vlerën 14.000 euro, e cila rrjedh nga të ardhurat e punës së tij mbi 10 vjet emigracion në Itali, si ortak i firmës “{\*\*\*}”, {\*\*\*}. Bashkangjitur gjendet dokumentacion<sup>68</sup> që referon vetëm punësimin e z. L. C. në këtë shoqëri në datën 03.11.2005, por jo të dhëna të gjeneruara.

**14.25.** Me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka depozituar ekstraktin e llogarisë së sigurimeve shoqërore të huadhënësit, lëshuar më datë 03.02.2023, nga INPS (Instituti i Sigurimeve Shoqërore Itali), të përkthyer dhe noterizuar. Nga dokumentacioni rezulton se huadhënësi ka realizuar të ardhura *bruto* në vlerën 34.528 euro, gjatë periudhës 01.07.1998 - 31.12.2006 (me disa shkëputje ndër vite). Referuar të dhënave statistikore nga EUROSTAT, shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë, vetëm për një person, rezultojnë në vlerën totale prej 58.461 eurosh<sup>69</sup>. Për pasojë, në kushtet që edhe të përllogaritura në vlerën e tyre *bruto* të ardhurat e provuara me dokumentacion janë të pamjaftueshme për përbalimin e shpenzimeve të jetesës, përjashtohet mundësia financiare për të kontribuar me huan në vlerën 14.000 euro pretenduar në favor të subjektit. Po ashtu, nga aktet rezulton se huadhënësi ka përfituar edhe kompensim *papunësie* për të gjithë vitin 2002, për *gjash të muaj* gjatë vitit 2004 [01.01.2004 – 17.07.2004] dhe ka qenë pa të ardhura në vitin 2005 ose për 30 muaj gjatë periudhës kohore pararendëse me huan. Këto fakte, në tërësi provojnë që situata financiare e huadhënësit nuk mund të argumentohet se ishte stabël dhe mjaftueshëm e shëndetshme që të bënte pretendimin për huadhënien subjektit për të krijuar një pasuri të dytë bindëse e të kuptimtë.

*c. Pretendimet për analizën financiare të kryer për pasurinë apartament në Tiranë*

**14.26.** Komisioni, përfundimisht, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë pasuri, pasi ka mungesë burimesh të ligjshme, sikurse përmbledhur më sipër në paragrafin 14.1. Pa përsëritur sa është referuar më sipër, këto balanca negative janë derivat i mungesës së burimeve të ligjshme për periudhën e viteve 2000-2003, për të krijuar pasuritë dhe mbuluar shpenzimet e ndryshme, balancës negative në vitin 2006, për shlyerjen e këstit në mars 2014, për efekt të blerjes së apartamentit. Komisioni e ka vlerësuar të pabesueshme situatën, sipas së cilës subjekti ka përfituar edhe dy huat në funksion të krijimit të pasurisë. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.

**14.27.** Në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm, subjekti kërkon që në analizën financiare për pasurinë objekt kontrolli duhet të kishin gjetur pasqyrim dy huat e marra në vitin 2006, detyrimi i mbetur pas çdo kësti dhe sipas çdo deklarimi vjetor dhe dinamika e likuiditeteve familjare ndër vite. Konkretisht, subjekti kërkon që Kolegji të marrë në konsideratë analizën financiare të paraqitur prej tij në Komision, për vitet 2000-2003, 2005-2006 dhe për vitin 2014. Sipas asaj analize dhe duke i konsideruar pasaktësitë jopenalizuese, rezultati financiar do të ishte pozitiv. Konkretisht, subjekti pretendon një analizë, sipas së cilës ai rezulton si vijon:

---

<sup>68</sup> (i) libro matricola dhe (ii) dichiarazione Istituto Nazionale Previdenza Sociale (INPS) - akte të përpiluara në gjuhën italiane të pa përkthyer në shqip, dorëzuar në formën fotokopje të panjësuar me vulë Aapostile.

<sup>69</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC\\_LI01\\_custom\\_5160774/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_5160774/default/table?lang=en)

- për periudhën 2000-2003, me balancë pozitive në vlerën 12.912 lekë. Në ndryshim nga Komisioni, subjekti ka mbartur balancën pozitive të rezultuar nga analiza e periudhës 1992-1999, në vlerën 3.067.191 lekë;
- në analizën e periudhës 2005-2006, subjektit i ka rezultuar e njëjta balancë pozitive prej 373.639 lekësh, sikurse në Komision e, për rrjedhojë, nuk ka kundërshtime për këtë vit. Ndërsa në analizën e vitit 2006, në ndryshim nga Komisioni, subjekti ka konsideruar dy huat e marra në këtë vit në vlerën totale 41.000 euro [huaja e marrë nga z. K. D. në vlerën 27.000 euro dhe huaja e marrë nga z. L. C. në vlerën 14.000 euro], duke rezultuar me një balancë pozitive në vlerën 1.296.676 lekë;
- për vitin 2014, subjekti pretendon se rezulton me balancë pozitive në vlerën 618.396 lekë. Në ndryshim nga Komisioni, subjekti në analizën e tij financiare ka konsideruar pakësimin e likuiditeteve *cash* në vlerën 10.000 euro, për pagesën e këstit të fundit, datë 17.03.2014, për blerjen e apartamentit në Tiranë.

**14.28.** Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, subjekti dhe personat e lidhur rezultuan edhe në Kolegj me *mungesë* burimesh të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë objekt analize. Po ashtu, edhe në Kolegj, subjekti dhe personat e lidhur rezultuan me *mungesë* të burimeve të ligjshme financiare për investimin në bono thesari, krijimin e likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 2000-2003 dhe për vitin 2006. Për vitin 2007, po ashtu, edhe nga analiza e kryer në Kolegj, subjekti nuk kishte mundësi të pakësonte likuiditetet *cash* në vlerën 12.000 euro. Në përmbledhje të sa më sipër, edhe për këtë pasuri, subjekti vlerësohet se gjendet në kushtet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Ky vlerësim u mbështet në kontrollin e analizës financiare të Komisionit, në të cilën u reflektuan konkluzionet e Kolegjit, përkundëjt atyre të Komisionit për secilin shkak ankimi të trajtuar gjerësisht më lart dhe përmbledhur në vijim.

**14.29.** Për efekt të analizës financiare, sikurse shtjelluar më lart, pavarësisht se mandatpagesat e depozituara nga subjekti nuk plotësojnë elementët e formës, sipas ligjeve që rregullojnë kontabilitetin, Komisioni i ka pranuar ato. Për rrjedhojë, në analizën e kryer në Kolegj, ato u pranuan nën dritën e garancive procedurale me ankimin. Dy huat, me vlerë 27.000 euro dhe 14.000 euro, njëjtë si Komisioni edhe në Kolegj, nuk u përfshinë në analizën financiare të apartamentit. Për rrjedhojë, në analizën e mundësisë financiare, për këstet e paguara për blerjen e kësaj pasurie, në Kolegj u përlllogaritën vetëm të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij ndër vite.

**14.30.** Në verifikim të mundësisë financiare për të likuiduar *këstin e parë, datë 07.06.2006, në vlerën 47.500 euro*, u vlerësua si vijon.

**14.30.a.** Subjekti nuk mund të kishte kursime të akumuluar *cash* deri në fund të vitit 1999, në konsideratë të faktit se nga analiza financiare për periudhën 1992-1999 [trajtuar në shkaku e parë të ankimit, për shtëpinë e banimit në Shkozë], subjekti rezultoi me *mungesë* burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 2.763.323 lekë.

**14.30.b.** Referuar shkresës të Bankës së Shqipërisë<sup>70</sup>, rezulton se subjekti ka bërë një investim në bono thesari në vlerën totale 3.300.000 lekë, ku vlera 2.850.000 lekë është investuar deri në vitin 2003 dhe vlera 450.000 lekë investuar në vitin 2004. Në datën 07.06.2006, është tërhequr gjithë investimi i kryer në bono thesari, në vlerën totale 3.300.000 lekë.

**14.30.c.** Nga kontrolli i kryer për periudhën 2000-2003, për të vërtetuar mundësinë financiare për të investuar në bono thesari në vlerën 2.850.000 lekë, si dhe mundësinë e krijimit të likuiditeteve *cash* në vlerën 2.150.000 lekë<sup>71</sup>, subjekti dhe personat e lidhur rezultuan edhe në Kolegj me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën (-) 3.054.279 lekë për investimin në bono thesari, krijimin e likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 2000-2003<sup>72</sup>.

**14.30.d.** Sa i përket investimit të kryer në vitin 2004 në bono thesari, në vlerën 450.000 lekë, u konfirmua edhe në Kolegj mundësia financiare e subjektit për të kryer këtë investim.

**14.30.e.** Nga analiza financiare e kryer për mundësinë e subjektit për investimin e kryer në bono thesari rezultoi se nga vlera totale 3.300.000 lekë, vetëm 2.336.187 lekë (1.886.187 lekë + 450.000 lekë) janë me burime të ligjshme. Diferenca prej 963.813 lekësh nuk provohet të jetë me burime të ligjshme e, si rrjedhojë, nuk u konsiderua si burim për pagesën e këstit të apartamentit.

**14.30.f.** Lidhur me kursimet e akumuluar *cash*, për vitin 2004, subjekti nuk ka deklaruar shtesa (duke u pranuar nga Komisioni pretendimi i tij se shtesa e deklaruar në vlerën 400.000 lekë është vetëm për bonot e thesarit), ndërsa për vitin 2005 subjekti ka deklaruar shtesa të kursimeve *cash* në vlerën 400.000 lekë. Referuar shpjegimeve për një hua rreth 2.000.000 lekë<sup>73</sup>, dhënë kumatës, pretenduar në pyetësonin nr. 1, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht faktit se analiza financiare e vitit 2005 ka rezultuar me balancë pozitive, që tregon se subjekti mund të krijonte kursimet *cash* të deklaruara në vlerën 400.000 lekë, subjekti i ka përdorur likuiditetet *cash* të akumuluar. Për rrjedhojë, ato nuk mund të kenë shërbyer si burim në momentin e pagesës së këtij kësti.

**14.30.g.** Bazuar në sa më sipër, edhe në Kolegj, rezultoi se për pagesën e këstit të parë, me vlerë 47.500 euro, në datën 07.06.2006, subjekti justifikon me burime të ligjshme vetëm vlerën 2.336.187 lekë, e cila derivon nga vlera totale e tërhequr nga bonot e thesarit në të njëjtën datë. Subjekti nuk kishte mundësi financiare në vlerën (-) 3.527.213 lekë<sup>74</sup> për të paguar këstin e parë në vlerën 47.500 euro, në datën 07.06.2006.

**14.31.** Në verifikim të mundësisë financiare për të likuiduar në datën 19.02.2007 këstin e dytë me vlerë 12.000 euro, u vlerësua si vijon.

---

<sup>70</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 26.01.2023.

<sup>71</sup> Duke pranuar shpjegimin e dhëna mbi pasaktësinë e deklarimit në DIPP 2003 si gjendje *cash* në banesë të të gjithë shumës prej 5.000.000 lekë.

<sup>72</sup> Mungesa e burimeve financiare në vlerën 3.054.279 lekë përbëhet nga: (i) mungesa në vlerën 963.813 lekë për investimin në bono thesari, nga vlera totale prej 2.850.000 lekësh. Vetëm diferenca prej 1.886.187 lekësh përbën burime financiare të ligjshme; (ii) mungesa në vlerën 2.090.466 lekë për krijimin e likuiditeteve *cash*, nga vlera totale prej 2.150.000 lekësh e deklaruar nga subjekti. Vetëm diferenca prej 59.534 lekësh përbën burime financiare të ligjshme.

<sup>73</sup> Sipas analizës së kryer për mundësinë e krijimit të likuiditeteve *cash* rezultoi se vlera e dhënë hua është me burime të paligjshme.

<sup>74</sup> Balanca negative e burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 3.527.213 lekësh përbëhet nga balanca negative prej 2.563.400 lekë dhe mungesa e burimeve të ligjshme në vlerën 963.813 lekë për krijimin e bonove të thesarit.

**14.31.a.** Për pagesën e këtij kësti, rezulton se i vetmi burim i mbetur për t'u përdorur kanë qenë likuiditetet *cash*. Analiza e mundësisë për krijimin e tyre u krye për vitet 2005 dhe vitet 2006, pasi në vitin 2004 nuk ka pasur shtesa likuiditeti *cash*. Nga ky kontroll financiar, viti 2005 rezultoi edhe në Kolegj me balancë pozitive për krijimin e kursimeve *cash* në vlerën 400.000 lekë. Ndërsa analiza financiare për vitin 2006, u krye vetëm për mundësinë e kursimit *cash*, duke mos përfshirë në analizë blerjen e këtij apartamenti si dhe burimin e përdorur (bonot e thesarit). Nga kjo analizë rezultoi se subjekti nuk kishte mundësi financiare në vlerën (-) 1.211.747 lekë për të krijuar kursimet *cash* në vlerën 400.000 lekë, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare në vitin 2006. Njësoj me Komisionin, balanca totale negative e vitit 2006, duke përfshirë edhe blerjen e apartamentit, edhe në Kolegj rezultoi në vlerën (-) 3.775.147 lekë<sup>75</sup>.

**14.31.b.** Bazuar në rezultatet e mësipërme lidhur me pagesën e kështit të dytë, datë 19.02.2007, në vlerën 12.000 euro, duke konsideruar se i vetmi burim që ka shërbyer për këtë pagesë janë kursimet *cash*, rezultoi edhe në Kolegj se nga pagesa e kështit në vlerën 1.458.000 lekë<sup>76</sup> vetëm kursimet e vitit 2005<sup>77</sup> në vlerën 400.000 lekë janë me burime të ligjshme, ndërsa diferenca prej 1.058.000 lekësh<sup>78</sup> rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare. Në vitin 2007, subjekti nuk kishte mundësi të pakësonte likuiditetet *cash* në vlerën 1.458.000 lekë (12.000 euro).

**14.32.** Si edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e *kështit të tretë* me vlerë 500 euro të kryer në datën 08.04.2009 dhe për pagesën e *kështit të katërt* datë 15.05.2010 me vlerë 4.000 euro.

**14.33.** Nga verifikimi i kryer në Kolegj, rezulton se *kësti i pestë* me vlerë 10.000 euro i kryer në datën 17.03.2016 nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike të pasurisë. Ndërkohë gjatë hetimit administrativ subjekti ka pretenduar se ndonëse në mandatin e dorëzuar prej tij referohet data 17.03.2016, pagesa faktike e këtij kësti është kryer në datën 17.03.2014. Duke abstraguuar nga kontradiktat e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit, për garanci procedurale ndaj subjektit në ankim, mbajti të njëjtin qëndrim si Komisioni duke pranuar si moment kohor të kësaj pagese datën 17.03.2014. Nga ana tjetër, Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit për të konsideruar si burim për pagesën e këtij kësti, pakësimin e kursimeve *cash* të akumuluar, për sa kohë ky pakësim likuiditeti nuk është deklaruar nga subjekti në DIPP-në 2014. Në këto kushte, në analizën financiare për periudhën 01.01.2014 - 17.03.2014, për mundësinë e subjektit për të paguar kështin me vlerë 10.000 euro në datën 17.03.2014, u konsideruan si burim vetëm të ardhurat e vitit. Nga kjo analizë, subjekti i rivlerësimit rezultoi edhe në Kolegj me pamundësi financiare në vlerën (-) 1.337.908 lekë, për të paguar kështin me vlerë 10.000 euro, në datën 17.03.2014.

**14.34.** Në përfundim, lidhur me blerjen e apartamentit me sip. 95,26 m<sup>2</sup>, në Tiranë, rezulton se subjekti në total ka pamjaftueshmëri financiare në vlerën (-) 5.923.121 lekë e konkretisht në vlerën

---

<sup>75</sup> Vlerë e cila përbëhet nga balanca negative e mundësisë së krijimit të kursimeve *cash* në vlerën (-) 1.211.747 lekë, si dhe balanca negative vjetore për blerjen e apartamentit në vlerën - 2.563.400 lekë (3.300.000 lekë të ardhura nga bono thesari - 5.863.400 lekë pagesa e kështit) duke përdorur tërheqjen e bonove të thesarit si i vetmi burim i ligjshëm. Analiza financiare e vitit 2006 është pasqyruar në analizën totale 2003-2016.

<sup>76</sup> Kursi i këmbimit 1 euro=121.5 lekë.

<sup>77</sup> Analiza financiare e vitit 2005 është me balancë pozitive dhe është pasqyruar në analizën totale 2003-2016.

<sup>78</sup> Për efekt të analizës financiare vjetore të vitit 2007, kjo vlerë është pasqyruar si ndryshim i likuiditeteve *cash* (shtesa 400.000 lekë – 1.458.000 lekë pagesa e kështit).

(-) 3.527.213 lekë<sup>79</sup> për të paguar këstin e parë, me vlerë 47.500 euro, në datë 07.06.2006, në vlerën (-) 1.058.000 lekë për të paguar këstin e dytë, me vlerë 12.000 euro, në datën 19.02.2007 dhe në vlerën (-) 1.337.908 lekë për të paguar këstin e pestë, me vlerë 10.000 euro, në datën 17.03.2014.

### III. Analiza financiare për periudhën 1992-2003 dhe periudhën e rivlerësimit 2004-2016

15. Komisioni ka konkluduar se referuar balancave negative në momentin e krijimit të pasurive të trajtuara më lart, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare me një vlerë totale prej (-) 12.741.724 lekësh, për blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të vlerësuara së bashku, e vendosin subjektin në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

15.1. Trupi gjykues konstatoi se edhe pas korrektimit të disa zërave të ankimuar nga subjekti e të pranuar në Kolegj, balanca negative e Komisionit në vendim zbutet në mënyrë të papërfillshme, duke mbetur sërish tejet e lartë, çka përjashton mundësinë e vlerësimit nën dritën e parimit të proporcionalitetit. Konkretisht, totali i vlerave negative të rezultuara në Kolegj për periudhën 1992-2003 rezulton të jetë në vlerën (-) 5.817.602 lekë<sup>80</sup>, ndërsa për të gjithë periudhën e rivlerësimit (2004-2016<sup>81</sup>), rezulton të jetë në vlerën (-) 6.526.210 lekë<sup>82</sup>. Në total, subjekti rezultoi me një balancë negative prej (-) 12.343.812 lekësh, shumë e përafërt me vlerën 12.741.724 lekë të rezultuar në Komision.

16. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta, të pavërteta dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a”, “b” dhe “ç” të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë dhe vendimi nr. 664, datë 24.05.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj e duhet të lihet në fuqi.

### PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

<sup>79</sup> Balanca negative e burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 3.527.213 lekësh përbëhet nga balanca negative prej 2.563.400 lekë për krijimin e likuiditeteve cash si dhe mungesa e burimeve të ligjshme në vlerën 963.813 lekë për krijimin e bonove të thesarit.

<sup>80</sup> Diferenca prej 193.498 lekësh nga vlera 6.011.100 lekë e përlllogaritur nga Komisioni vjen si rezultat i përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për vitin 1998-1999 në masën 30% të të ardhurave.

<sup>81</sup> Analiza e vitit 2003 është kryer në analizën financiare për periudhën 2000-2003 nga ku subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 3.054.279 lekë.

<sup>82</sup> Për vitin 2006 në vlerën (-) 3.775.147 lekë; për vitin 2008 në vlerën (-) 1.617.569 lekë dhe për vitin 2014 në vlerën (-) 1.133.494 lekë.

## **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 664, datë 24.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Hysa.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 19.06.2025.

### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

### **RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

### **KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*